



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 42, datë 14.10.2022

PËR LEJIMIN E KANDIDATURËS SË ZOTIT GENTI IBRAHIMI NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 13.01.2022

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Sokol Binaj	Kryetar
Marsida Xhaferllari	Zëvendëskryetare
Elsa Toska	Anëtare relatores
Anila Leka	Anëtare
Edlira Petri	Anëtare
Enton Dhimitri	Anëtar
Etien Kapo	Anëtar
Klodiana Mema	Anëtare
Genti Xholi	Anëtar zëvendësues

Asistuar nga sekretare Ermelinda Kadiu,

Me praninë e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

-zotit Eduart Seitaj dhe z. Alket Jaupi përfaqësuesit të autorizuar të Presidentit të Republikës,

-zonjës Mimoza Arbi, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës 10.08.2022, 08.09.2022, dhe 14.10.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATI: Genti Ibrahim

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës në datë 13.01.2022.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjo i relativimin e anëtares së Këshillit, zonjës Elsa Toska, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, si dhe si bisedoi çështjen në tërësi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 8577/2000), Presidenti i Republikës, në datën 13.01.2022, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e plotë, e krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Përparim Kalo.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, ndër të tjerët edhe kandidatin Gent Ibrahimimi.

3. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit nr. 2, datë 15.02.2019 të KED, si edhe të pikës 4 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 të KED, i ndryshuar, në mbledhjen së zhvilluar në datën 14.02.2022, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese.

4. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 13.01.2022, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Elsa Toska, ndërsa këshilltar ligjor, zonja Aulona Bodo.

5. Zoti Gent Ibrahimimi, (“kandidati”) si një nga kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED, i ndryshuar, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim datë 15.02.2022, është kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati si dhe gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

6. Në datën 17.02.2022, kandidati është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të emërimeve në Drejtësi dhe ka tërhequr formularët e deklaratave, autorizimeve dhe informacioneve të përcaktuara sipas ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED, i ndryshuar.

7. Në datën 18.02.2022, nëpërmjet formës elektronike të njoftimit (i cili është i administruar në dosje), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka njoftuar kandidatin në lidhje me vijim e procedurave të verifikimit, duke i bërë me dije se: “...Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ju vë në dijeni se nga dita që ju keni tërhequr dokumentacionin e nevojshëm pranë Zyrës së Sekretarisë së KED, keni detyrimin për të dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 115/2016, i ndryshuar si dhe akteve nënligjore që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar për procedurat e verifikimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilat janë aktualisht në fuqi. Në lidhje me plotësimin e formularit të deklarimit të pasurisë, ju bëjmë me dije se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi sot në mbledhjen e saj të datës 18.02.2022, ka marrë në shqyrtim propozimin e bërë nga Kryetari i Këshillit në lidhje me miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. “Për

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë”, propozim i cili ka ardhur me qëllim përshtatjen dhe harmonizimin e legjislacionit që rregullon veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për verifikimin e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese me kuadrin ligjor të ILDKPI-së, për sa i përket rregullave për plotësimin e formularit të Deklarimit të Pasurisë në formë elektronike. Deri në momentin që ky akt do të miratohet dhe do të hyjë në fuqi sipas ligjit, ju si kandidatë, keni detyrimin që të zbatoni rregullat aktuale në fuqi, të bëra me dijenë edhe në aktet që ju keni tërhequr pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Për çdo lloj zhvillimi në lidhje me sa më sipër, ju si kandidatë do të njoftoheni nëpërmjet formës elektronike nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi...”.

8. Në datën 23.02.2022, kandidati ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizime përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit. Për këtë arsye janë mbajtur edhe proces-verbalet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit, të cilët janë regjistruar me nr. 102 prot., datë 23.02.2022 dhe nënshkruar nga kandidati dhe punonjësi i administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

9. Në datën 04.03.2022, kandidati ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi autorizimin e lëshuar nga personat e lidhur për Verifikimin e Pasurisë, Interesave Private dhe Detyrimeve Financiare për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit. Për këtë arsye është mbajtur edhe proces-verbali i marrjes në dorëzim të dokumentacionit, i cili është regjistruar me nr. 102/1 prot., datë 03.03.2022 dhe nënshkruar nga kandidati dhe punonjësi i administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

10. Në datën 04.03.2022, kandidati është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe ka dorëzuar formularin për vetëdeklarim sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për të cilin është mbajtur edhe proces-verbali përkatës me nr. 102/2 prot., datë 04.03.2022, i nënshkruar nga kandidati dhe punonjësi i administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

II. Verifikimi i kushteve dhe kritereve kushtetuese dhe ligjore

i. VERIFIKIMI I SHTETËSISË DHE ZOTËSISË PËR TË VEPRUAR

11. Neni 7/a pika 1 shkronja “a” e ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi shtetësinë shqiptare dhe zotësinë e plotë për të vepruar.

12. Kandidati rezulton me shtetësi shqiptare, të konfirmuar nga karta e identitetit me numër personal **H00320090S**. Përgjatë procedurës së verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që këtij kandidati t’i jetë hequr apo t’i jetë kufizuar zotësia për të vepruar.

ii. VERIFIKIMI I ARSIMIT

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

13. Neni 125 pika 4 e Kushtetutës dhe neni 7/a pika I shkronja "b" e ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi "arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë".

14. Kandidati ka kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ai është diplomuar Jurist, e pajisur me Diplomë Nr. 2170, Nr. 1813 regj., datë 06.07.1992. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ky lloj arsimimi kualifikohet arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

iii. PËRVOJA PROFESIONALE

15. Neni 125 pika 4 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 2 e ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi përvojën e punës prej të paktën prej 15 vjet në detyrën e gjyqtarit, prokurorit, avokatit, profesorit ose lektorit të së drejtës, nëpunësit të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës, si dhe të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

16. Me qëllim provueshmërinë e viteve të punës, si dhe plotësimit të dokumentacionit shkresor provues, në datën 09.03.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi ka verifikuar dokumentacionin e sjellë nga kandidati, i është drejtuar këtij të fundit, duke i bërë me dije se: "Në zbatim të Kushtetutës, ligjit nr. 8577/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Këshilli i Emërimeve në Drejtësi po procedon me veprimet për verifikimin e kandidaturës suaj. Ndërkohë që vlerësojmë se, në kuadër të depozitimit të dokumentacionit dhe informacioneve të kërkuara në funksion të procedurës së verifikimit, jeni i lutur të dorëzoni librezën e punës ose vërtetime nga punëdhënësit tuaj, ku provohet periudha e punësimit, (koha e fillimit dhe e mbarimit të marrëdhënies së punës), të deklaruar nga ana juaj sipas CV-së përkatëse. Gjithashtu, tek të dhënat e kërkuara, përveç periudhës së punësimit, duhet të jetë parashikuar pozicioni i punës që keni mbajtur, shkaqet e largimit prej tyre, si dhe në rast se keni marrë ndonjë masë disiplinore, gjatë kryerjes së detyrës suaj....".

17. Në datën 15.03.2022, kandidati ka depozituar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, disa vërtetime të cilat konsistojnë në: (i) vërtetimin e datës 15.02.2022 të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Dega e Burimeve Njerëzore; (ii) dy vërtetimet e lëshuara nga Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore të datës 09.03.2022; (iii) shkresën me nr. 1484 prot., datë 10.03.2022 të lëshuar nga Njësia e Buxhetit dhe e Administrimit në Kryeministri; (iv) Vendimin nr. 3, datë 19.12.2018 dhe vendimin nr. 33, datë 02.03.2018 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; (v) Certifikatën që provon angazhimin e tij si Ekspert i Nivelit të Lartë për draftimin e reformës në Drejtësi. Të gjitha këto akte janë administruar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nëpërmjet proces verbalit me nr. 298 prot., datë 15.03.2022, të nënshkruar mes kandidatit dhe punonjësit të administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (këto akte gjenden të administruara në dosjen e kandidatit).

18. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka kërkuar informacion tek të gjitha institucionet dhe subjektet juridike pranë të cilave kandidati ka deklaruar se ka qenë i punësuar apo që ka ushtruar veprimtarinë profesionale. Kështu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i është drejtuar për të marrë informacion në lidhje me angazhimin dhe veprimtarinë profesionale disa institucioneve si: (i)

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Kuvendit të Shqipërisë (shkresa me nr. 329 prot., datë 23.03.2022); (ii) Këshillit të Ministrave (shkresa me nr. 328 prot., datë 23.03.2022, e perseritur); (iii) Universitetit të Tiranës (shkresa me nr. 325 prot., datë 23.03.2022); (iv) Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (shkresa me nr. 326 prot., datë 23.03.2022); (v) Institutit për Studime Publike dhe Ligjore (shkresa me nr. 327 prot., datë 23.03.2022).

19. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati në fillim të hetimit administrativ, pra kryesisht nga jetëshkrimi (CV) i tij, ka rezultuar ai ka mbajtur disa pozicione pune. Për këtë arsye, në datën 23.03.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i është drejtuar kandidatis në rrugë elektronike, duke i bërë me dije se: “...Nga aktet e administruara në dosje, konkretisht referuar të dhënave që pasqyrojnë aktet e paraqitura dhe depozituara nga ana juaj, por edhe jetëshkrimi (CV), ka rezultuar se kenë mbajtur disa pozicione pune si më poshtë vijon: ...

1. Për periudhën Janar 1994 deri në Tetor 1996, Pedagog i së drejtës, Lënda E Drejtë Administrative;
2. Për periudhën Maj 1995 deri në Tetor 1997, Administrator i Programit për Shtetin e së Drejtës në Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (Soros)
3. Për periudhën nga data 01.10.1997 deri në datën 15.03.1999, Këshilltar ligjor në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin (pranë Këshillit të Ministrave);
4. Për periudhën nga data 15.03.1999 deri në datën 15.06.1999, Drejtor i Kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin (pranë Këshillit të Ministrave);
5. Për periudhën nga data 31.03.1999 deri në datën 11.10.2007, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Institutit për Studime Publike dhe Ligjore”;
6. Për periudhën nga data 11.10.2007 deri në datën 13.02.2013, jurist pranë Fondacionit “Institutit për Studime Publike dhe Ligjore”;
7. Për periudhën nga data 13.02.2013 deri në datën 17.12.2018, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Institutit për Studime Publike dhe Ligjore”;
8. Për periudhën Shtator 2007 deri në Dhjetor 2013, anëtar i Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive);
9. Për periudhën nga data 19.12.2018 deri në Dhjetor 2021, anëtar dhe njëkohësisht Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

Në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte: a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë; c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit; ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale; d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi; dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

Në vijim, në pikën 2 të këtij neni, parashikohet se: “2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere: a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike; b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës; c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral. 3. Plotësimi i kritereve të mësipërme vlerësohet në bazë të: a) vjetërsisë në profesion; b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë; c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

fushë tjetër të së drejtës; ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike; d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës; dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike...”. Referuar eksperiencës suaj të punës, rezulton se keni mbajtur disa funksione dhe detyra, ku për disa periudha, ato mbivendosen me njëra-tjetrën.

Kështu, rezulton se:

1. Gjatë periudhës 15.03.1999 deri në datën 15 Qershor 1999, ju keni deklaruar se keni mbajtur funksionin e Drejtorit të Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin (pranë Këshillit të Ministrave), e cila mbivendoset me periudhën 31.03.1999 deri në datën 11.10.2007, kohë në të cilën keni mbajtur detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit “Instituti për Studime Publike dhe Ligjore”;
2. Gjatë periudhës 11.10.2007 deri në datën 13.12.2013 ju keni deklaruar se keni mbajtur funksionin e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit, periudhë e cila mbivendoset me periudhën Shtator 2007 deri 13.02.2013, kohë në të cilën ju keni mbajtur detyrën e juristit pranë Fondacionit “Instituti për Studime Publike dhe Ligjore”;
3. Gjithashtu, periudha 11.10.2007 deri në datën 13.12.2013 ju keni deklaruar se keni mbajtur funksionin e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit, mbivendoset me periudhën 13.02.2013 deri në datën 17.12.2018, periudhë në të cilën ju keni mbajtur detyrën si Drejtor Ekzekutiv pranë Fondacionit “Instituti për Studime Publike dhe Ligjore”.

Në vijim të dispozitave ligjore të mësipërme, si dhe referuar viteve të punës dhe eksperiencës suaj profesionale, brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi me e-mail, **lutemi bëni me dije qëndrimin tuaj në lidhje me plotësimin e kushtit ligjor të 15 viteve si jurist i nivelit të lartë në administratën publike, në kuptim të nenit 7/a, pika 2, shkronja “a”....”.**

20. Në vijim të këtij komunikimi, nga ana e kandidatit Genti Ibrahimimi në datën 28.03.2022, ka dhënë në formë elektronike shpjegimet e tij në lidhje me sa i është kërkuar nga KED, duke bërë me dije ndër të tjera se: “....Me poshtë do të gjeni shpjegimet e mia në lidhje me plotësimin e kushtit ligjor të 15 viteve si “jurist i nivelit të lartë” në kuptim të nenit 7/a, pika 2, shkronja “a” të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”:

Së pari me lejoni një saktësim në lidhje me periudhën e shërbimit në Këshillin e Lartë të Prokurorise (KLP). Periudha e saktë e shërbimit në KLP është nga data 18.12.2018 deri në datën 28.02.2022. Ju lutem gjeni bashkëngjitur Vendimin e Këshillit për mbarimin e mandatit. Pra në total, periudha e shërbimit në KLP është **3 vjet e 2 muaj e 14 ditë**:

Se dyti, sa i takon periudhës së shërbimit si anëtar i Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit (KKRT sot AMA) nga data 11.10.2007 deri në datën 13.12.2013 (në total **6 vjet e 2 muaj e 2 ditë**), dhe mbivendosjes së pjesëshme të kësaj periudhe me kohën e shërbimit si Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Instituti për Studime Publike dhe Ligjore” - ISPL (periudha kohore 13.02.2013 deri në 13.12.2013), ju bej me dije se sipas legjislacionit të kohës, shërbimi në KKRT ishte me kohë të pjesëshme. Në keto kushte ishte e mundur për mua të punoja si drejtor i fondacionit të sipërmendur:

Se treti, ju bej me dije se shpjegimi i mësipërm vlen edhe për konstatimin e mbivendosjes së pjesëshme midis periudhës së shërbimit në KKRT në harkun kohor 11.10.2007 - 13.12.2013 me periudhën e shërbimit si jurist pranë ISPL në harkun kohor shtator 2007 - 13.02.2013;

Se katërti, sa i takon mbivendosjes së pjesëshme midis periudhës së shërbimit si Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin në harkun kohor 15.03.1999 - 15.06.1999 (në total koha e shërbimit në Këshillin e Ministrave **1 vit e 8 muaj e 15 ditë**), me periudhën e shërbimit si Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Instituti për Studime Publike dhe Ligjore” - ISPL në harkun kohor 31.03.1999 - 11.10.2007, ju bej me dije se

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA ELARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

funksonet ne ISPL gjate periudhes se mbivendosjes jane kryer me kohe te pjeseshme duke qene se fondacioni ishte i sapo krijuar.

Se pesti, sa i takon plotesimit te kushtit ligjor te 15 viteve ne teresi kam shpjegimet e meposhteme:

- a) 3 vite, 2 muaj e 14 dite ne Keshillin e Larte te Prokurorise (vertetimi perkates dorezuar ne KED);
- b) 6 vite, 2 muaj e 2 dite ne Keshillin Kombetar te Radios e Televizionit (vertetimi perkates dorezuar ne KED);
- c) 1 vit, 8 muaj e 15 dite ne Keshillin e Ministrave (vertetimi perkates dorezuar ne KED);
- d) 3 vite, 6 muaj e 0 dite ne Fakultetin e Drejtësisë te Universitetit te Tiranës (vertetimi perkates dorezuar ne KED);
- e) 7 vite, 0 muaj e 0 dite ne Shkollen e Magjistratures (vertetimi perkates dorezuar ne KED).

Totali i viteve te punes qe perkon qartesisht me percaktimin e "pervojes se punes" si "jurist i nivelit te larte" sipas nenit 7/a, pika 2. shkronja "a" te ligjit "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykates Kushtetuese te Republikës së Shqipërisë" eshte: **21 vite e 7 muaj e 0 dite.**

Se fundi, me lejoni disa rreshta permes te cileve dua te argumentoj se pervoja ime e punes eshte ne te vertete shume me e madhe se kaq (**21 vite e 7 muaj**). Dua te theksoj se gjate kohes se punesimit prane ISPL une jam angazhuar ne menyre kontraktore nga institucione te rendesishme kombetare dhe nderkombetare per kryerjen e detyrave te rendesishme ligjore qe kerkonin nje nivel te larte ekspertize, te tilla qe perkojne me konceptin ligjor "Jurist i Nivelit te Larte". Keshtu psh, ne harkun kohor janar 2015 - korrik 2016 (**1 vit e 6 muaj**), gjate kohes se punesimit ne ISPL, une jam angazhuar nga Kuvendi si ekspert i nivelit te larte per hartimin e ndryshimeve ne Kushtetute dhe te ligjeve kryesore post kushtetuese ne fushen e drejtësisë (bashkengjitur vertetimi perkates). Po keshtu nder vite kam kryer pune te rendesishme per institucione te rendesishme nderkombetare si Bashkimi Evropian, Keshilli i Evropes, OSBE, OKB, OECD, USAID, DANIDA, SIDA dhe shume kompani nderkombetare te cilat gjithashtu kerkonin nje nivel te larte ekspertize. Per sa me siper jam i gatshem te vendos ne dispozicionin Tuaj dhe te KED te gjithë dokumentacionin e nevojshem.

Ne keto kushte do te kerkoja nga Ju dhe nga KED qe ne llogaritjen e viteve te mia te punes te perfshihet e gjithë periudha e punesimit nga janari 1994 deri me sot, pra 29 vite.

Duke shpresuar qe i jam pergjigjur qarte pyetjeve Tuaja mbetem ne dispozicion per cdo sqarim te metejshem.... ».

21. Për të provuar përvojën e tij profesionale, kandidati Gent Ibrahim i ka paraqitur këto akte: (i) vërtetimin e datës 15.02.2022 të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Dega e Burimeve Njerëzore, si dhe shkresa me nr. 270/2 prot., datë 07.04.2022 të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë; (ii) dy vërtetimet e lëshuara nga Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore të datës 09.03.2022; (iii) shkresën me nr. 1484 prot., datë 10.03.2022 të lëshuar nga Njësia e Buxhetit dhe e Administrimit në Kryeministri, me kërkesë të vetë kandidatit; (iv) Vendimin nr. 3, datë 19.12.2018 dhe vendimin nr. 33, datë 02.03.2018 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; (v) vërtetimin nr. 3965 prot., datë 16.12.2021 të Autoritetit të Mediave Audiovizive¹. Një pjesë e vërtetimeve që provojnë vjetërsinë në punë të kandidatit, janë administruar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nëpërmjet proces-verbalit nr. 21/6 prot., datë 09.02.2022 dhe atij me nr. 298 prot., datë 15.03.2022, të nënshkruar mes kandidatit dhe punonjësit të administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (këto akte gjenden të administruara në dosjen e kandidatit).

22. Me qëllim vërtetimin e vjetërsisë si pedagog të kandidatit, si dhe në mungesë të dorëzimit të librezës së punës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka bërë një hetim të thelluar, duke iu drejtuar Shkollës së Magjistraturës me shkresën me nr. 489 prot., datë 09.06.2022, duke i kërkuar

¹ Administruar në dosje me procesverbalin nr. 21/6 prot., datë 09.02.2022 dhe procesverbalin nr. 505/I prot., datë 18.07.2022.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

informacion për këto çështje: “.....Cila është natyra e marrëdhënies profesionale që kandidatët **Gent Ibrahim** dhe kanë ose kanë pasur me Shkollën e Magjistraturës, duke qartësuar nëse ka qenë ose janë pedagog të jashtëm, pedagog efektiv apo ekspert në Programin e Trajtimit Vazhdues? Si është rregulluar kjo marrëdhënie juridike mes kandidatëve dhe Shkollës së Magjistraturës, duke na vënë në dispozicion kontratat përkatëse nëse ka të tilla.

23. Me shkresën nr. 486/1 prot., datë 21.06.2022, Shkolla e Magjistraturës i ka kthyer përgjigje Këshillit të Emërimeve në Drejtësi duke i bërë me dije se: “...Z. **Gent Ibrahim** është miratuar ekspert në programin e Formimit Vazhdues për vitin akademik 2015-2016, sipas pasqyrës së kurseve nr. 760/1 prot., datë 28.09.2015. Gjithashtu z. **Ibrahim** është pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës që prej vitit akademik 2016-2017, miratuar fillimisht me vendim të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 21.12.2016 “Për miratimin e planit dhe programit mësimor të vitit të parë dhe listës së pedagogëve/specialistëve të jashtëm për vitin akademik 2016-2017”. Z. **Ibrahim** vazhdon të japë lëndën “Etikë profesionale”, e cila, zhvillohet në vitin e parë të Programit të Formimit Fillestar....”.

24. Po ashtu me datë 25.07.2022, kandidati ka paraqitur edhe një herë argumentet e tij mbi plotësimin e kriterëve të viteve të punës për sa vijon: “...Në vijim të komunikimeve tonë të vazhdueshme elektronike më lejoni tu vë në dispozicion edhe njëherë, shpjegimet dhe llogaritë e mia në lidhje me plotësimin e kushtit ligjor të 15 viteve si “jurist i nivelit të lartë”, në kuptim edhe të nenit 7/a, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” si më poshtë:

Vendi i punës	Vite	Muaj	Ditë	Periodha
Këshilli i Lartë i Prokurorisë	3	2	14	19.12.2018 – 28.2.2022; vendimi i datës 19.12.2018 dhe vendimi i datës 02.02.2022
Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit (KKRT) sot AMA	6	2	15	Shtator 2007 – dhjetor 2013; Vërtetimi nr. 3865, datë 16.12.2021
Këshilli i Ministrave	1	8	15	01.10.1997- 15.06.1999; Vërtetimi nr. 484, datë 10.03.2022.
Universiteti i Tiranës; Fakulteti i Drejtësisë	3	6	0	Nëntor 1993-prill 1997; Vërtetimi datë 15.03.2022.
Shkolla e Magjistraturës (SHM)	7	0	0	Shtator 2016 e në vijim
Parlamenti/Komisioni i Posaçëm, i Reformës në Drejtësi	1	7		Janar 2015- Korrik 2016
Totali	21	25	44	

Sqarim: 25 muaj janë 2 vite e 1 (një) muaj dhe 44 ditë janë 1 (një) muaj e 14 ditë. Totali 23 vite e 2 muaj e 14 ditë.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Se fundi, me lejoni disa rreshta permes te cileve dua te argumentoj se pervoja ime e punes eshte ne te vertete shume me e madhe se kaq (21 vite e 7 muaj). Dua te theksoj se gjate kohes se punesimit prane ISPL une jam angazhuar ne menyre konstante nga institucione te rendesishme kombetare dhe nderkombetare per kryerjen e detyrave te rendesishme ligjore qe kerkonin nivel te larte ekspertize te tilla qe perkojne me konceptin kushtetues "Jurist i Nivelit te Larte". Keshitu psh., nder vite kam kryer pune te rendesishme per institucione te nderkombetare si Bashkimi Evropian, Keshilli i Evropes, OSBE, OKB, OECD, USAID, DANIDA, SIDA dhe shume kompani nderkombetare te cilat gjithashtu kerkonin nje nivel te larte ekspertize. Per sa me sipër, do te kerkoja nga KED nje rishikim ne rritje te viteve te punes...

25. Përfundimisht, pas analizimit të të gjitha akteve shkresore të paraqitura nga kandidati Gent Ibrahim, si dhe hetimit të thelluar që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka kryer për verifikimin e vjetërsisë profesionale të tij, rezulton se ky kandidat ka këtë përvojë profesionale, si më poshtë:

- a) Për periudhën 1993 deri 1996, Pedagog efektiv i së drejtës, Lënda E Drejtë Administrative; Për vitin 1993-1994 dhe për vitin 1994-1995 disponohet kontratë pune. Për vitin akademik 1995 -1996 nuk disponohet kontratë pune, por rezulton të jetë pedagog efektiv nga pasqyra e ngarkesës mësimore². (....)
- b) Për periudhën Maj 1995 deri në 30 Shtator 1997, Administrator i Programit për Shtetin e së Drejtës në Fondacionin "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë" (Soros) (gjithsej 2 vjet e 4 muaj);
- c) Për periudhën nga data 01.10.1997 deri në datën 15.03.1999, Këshilltar ligjor në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin (pranë Këshillit të Ministrave) (gjithsej 1 vit, 4 muaj e 15 ditë);
- d) Për periudhën nga data 15.03.1999 deri në datën 15.06.1999, Drejtor i Kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin (pranë Këshillit të Ministrave) (gjithsej 3 muaj);
- e) Për periudhën nga data 31.03.1999 deri në datën 11.10.2007, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit "Instituti për Studime Publike dhe Ligjore" (gjithsej 8 vjet, 6 muaj 11 ditë).
- f) Për periudhën nga data 11.10.2007 deri në datën 13.02.2013, jurist pranë Fondacionit "Instituti për Studime Publike dhe Ligjore" (gjithsej 5 vjet, 5 muaj dhe 3 ditë).
- g) Për periudhën nga data 13.02.2013 deri në datën 17.12.2018, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit "Instituti për Studime Publike dhe Ligjore" (5 vjet, 10 muaj dhe 4 ditë).
- h) Për periudhën Shtator 2007 deri në Dhjetor 2013, anëtar i Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) (gjithsej 6 vjet e tre muaj);
- i) Për periudhën nga data 19.12.2018 deri në momentin e kandidimit në datë 02.02.2022, anëtar dhe njëkohësisht Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë (gjithsej 3 (tre) vjet, 1 (një) muaj dhe 14 ditë);
- j) Për periudhën, vitin akademik 2015-2016 ekspert i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa nga data 21.12.2016 e në vijim pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës³. (gjithsej 5 vjet si titullar lënde/pedagog i jashtëm dhe për periudhën vjetore akademike 2015-2016 si ekspert i kontraktuar nga Shkolla e Magjistraturës, angazhim mbi baza ditore, (referojuni pasqyrës së kurseve për vitin akademik 2015-2016 me nr. 760/1 prot., datë 28.12.2015 dhe pasqyrës së kurseve për vitin akademik 2016-2017, pasqyruar me shkresën nr. 1134/1 prot., 07.11.2016).

² Këto të dhëna dalin nga shkresa me nr. 270/2 prot., datë 07.04.2022 i Fakultetit të Drejtësisë. Ndërkohë me vërtetimin e dates 15.03.2022 lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, i depozituar nga vetë kandidati në KED, vërtetohet se ai ka qenë pedagog për lëndën "E drejtë administrative", për periudhën nëntor 1993 deri në prill 1997.

³ Referojuni përmbajtjes së shkresës nr. 468/1 prot., datë 21.06.2022 të Shkollës së Magjistraturës, administruar në dosjen e kandidatit dhe cituar në këtë relacion.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

iv. VERIFIKIMI I FUNKSIONEVE POLITIKE

26. Neni 125 pika 5 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1 shkronja "c" i ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë dhjetë viteve të fundit nga data e kandidimit.

27. Kandidati ka kandiduar në datën 04.02.2022. Për pasojë, verifikimi është realizuar për periudhën 10 vjeçare "04.02.2012 –04.02.2022". Sa i takon *pozicioneve drejtuese në parti politike*, KED në datat 23.02.2022 dhe 30.03.2022 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Duhet evidentuar fakti se pjesa më e madhe e partive politike nuk kanë kthyer përgjigje. Kanë kthyer përgjigje gjithsej 5 parti politike, të cilat konfirmojnë në thelb se "duke filluar nga viti 2012 kandidati nuk ka mbajtur funksione drejtuese apo të ketë qenë anëtar partie".

28. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 2, datë 23.02.2022, vendosi "Miratimin e formularit të vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit". Ky vendim hyri në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 33, datë 01.03.2022. Në vijim, në datë 03.03.2022 është njoftuar me e-mail kandidati të paraqes këtë formular të plotësuar, jo më vonë se 3 ditë nga marrja e këtij njoftimi.

29. Kandidati, në datë 04.03.2022 ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike. Për dorëzimin e këtij formulari është mbajtur edhe proces-vebali me nr. 102/2 prot., datë 04.03.2022, i cili është nënshkruar nga vetë kandidati Gent Ibrahimini dhe punonjësi i administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

v. VERIFIKIMI I INTEGRITETIT

30. Neni 125 pika 5 i Kushtetutës parashikon se kritere të tjera për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Neni 7/a pika 1 shkronjat "ç" dhe "d" të ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë kushtet e kandidimit që kandidati: "ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale" dhe "d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi". Neni 236 i ligjit nr. 115/2015 dhe ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar (në vijim ligji nr. 138/2015), përcaktojnë që kandidati duhet të mos jetë i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të mos ketë pasur masë sigurimi personal ose urdhër dëbimi, për një listë veprash penale të parashikuara shprehimisht nga ligji. Ndërsa neni 29 i ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" përcakton si kusht ndalues kandidimi nëse kandidati ka qenë ose jo person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, bashkëpunëtor aktiv i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe nëse figuron ose jo në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

31. Lidhur me verifikimin e të dhënave të dekriminalizimit, KED, në bazë të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikës 82 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, me shkresën nr. 109 prot., datë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

28.02.2022 ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, për kompetencë verifikimi formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati sipas ligjit nr. 138/2015.

31.1. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 281/1 prot., datë 09.03.2022 informon Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, që prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar informacion të plotë në lidhje me kërkesat e shkresës së KED, pranë prokurorive të rretheve. Gjithashtu, po në këtë shkresë, Prokuroria e Përgjithshme ka bërë me dije faktin se për disa nga subjektet që ishin listuar në shkresën e KED, një ndër të cilët edhe kandidati Genti Ibrahim, ka një vendimmarrje të mëparshme mbi miratimin e rezultateve të verifikimit. Konkretisht bashkëlidhur kësaj shkrese është vënë në dispozicion vendimi i datës 18.10.2017, sipas të cilit kandidati Gent Ibrahim nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të Ligjit nr. 138/2015.

31.2. Me shkresën nr. 281/41 prot., datë 08.04.2022 të Prokurorisë së Përgjithshme, është dërguar vendimi i datës 06.04.2022 "Për mospranimin e kërkesës për verifikim të thelluar", për kandidatin për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, z. Genti Nesip Ibrahim. Ndërsa me shkresën nr. 281/42 prot., datë 08.04.2022, Drejtoria e Koordinimit Institucional pranë Prokurorisë së Përgjithshme, i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të gjithë informacionin e kërkuar pranë prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm dhe të apelit. Nga kjo korrespondencë ka rezultuar se ndaj kandidatit Genti Ibrahim nuk ka rezultuar asnjë e dhënë në lidhje me procedime penale ndaj tij.

31.3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me qëllim verifikimin e integritetit, të lidhur me *pastërtinë e figurës dhe të gjendjes gjyqësore* të kandidatit Genti Ibrahim, në zbatim të shkronjës "ç" të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", KED i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve në mënyrë të pavarur nga Prokuroria e Përgjithshme, Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, Gjykatave të Apelit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (*shkresa nr. 317 prot., datë 18.03.2022*); me kërkesë për informacion Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, pranë Gjykatës së Apeleve dhe SPAK (*shkresa nr. 317 prot., datë 18.03.2022*); me kërkesë për informacion Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (*shkresa nr. 318 prot., datë 18.03.2022*).

31.4. Nga korrespondenca e mbajtur me prokuroritë dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ka ardhur përgjigje negative në lidhje me kandidatin, duke konfirmuar se ndaj tij nuk rezulton të ketë filluar ndonjë procedim penal, apo të jetë dhënë ndonjë vendim i formës së prerë. Përgjigje negative është dhënë edhe nga ana e Gjykatës së Lartë nëpërmjet shkresës me nr. 1286/1 prot., datë 28.03.2022.

31.5. Me shkresën nr. 2238/1 prot., datë 18.03.2022, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka bërë me dije se: *"...pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk rezulton që në emër të shtetasve të mëposhtëm të jetë regjistruar ndonjë procedim penal...6. Kandidat Genti Nesip Ibrahim..."*

31.6. Me shkresën nr. 384/1 Prot., datë 28.03.2022, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka bërë me dije Këshillin e Emërimeve në Drejtësi në

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: **GJYKATA ELARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

lidhje me: "...informojmë se në lidhje me subjektet:- Genti Nesip Ibrahim, i datëlindjes 20.03.1970:rezulton se pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk ka të regjistruar aktualisht në gjykim çështje penale; si dhe nuk janë dhënë vendime penale qoftë edhe të formës së prerë apo jo, në ngarkim të subjekteve të sipërcituara....".

31.7. Me shkresën me nr. 169/1 prot., datë 29.03.2022, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se: "...Ju bëjmë me dije se nga verifikimi i regjistrave të ish-Gjykatës së Apelit për krimet e rënda Tiranë dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe krimin e organizuar, për shtetasit e listuar si kandidatë, Konkretisht: "...6. Genti Nesip Ibrahim, i datëlindjes 20.03.1970.... a) nuk rezultoi të jetë regjistruar për shqyrtim asnjë çështje penale në ngarkim të kandidatëve për në Gjykatë Kushtetuese; b) nuk janë dhënë vendime penale qoftë të formës së prerë apo jo, në ngarkim të kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese". Bazuar në këtë informacion, si dhe atë të dhënë nga Gjykata e Lartë me shkresën nr. 1286/1 prot., datë 28.03.2022, arrihet në konkluzionin se ndaj kandidatit Genti Ibrahim nuk ka asnjë të dhënë që ai të jetë marrë në përgjegjësi penale, ndaj saj të jetë filluar ndonjë procedim penal, apo të jetë dhënë ndonjë vendim penal i formës së prerë.

32. Lidhur me verifikimin e të dhënave të dekriminalizimit, KED, në bazë të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikës 82 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, me shkresën nr. 314 prot., datë 18.03.2022 dhe nr. 404 prot., datë 30.03.2022 ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, për kompetencë verifikimi formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Genti Ibrahim sipas ligjit nr. 138/2015.

32.1. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 645/2 prot., datë 30.03.2022, ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si vijon: "Në përgjigje të kërkesës për informacion nëse nga ana jonë disponohen të dhëna për dënime penale nga autoritetet gjyqësore të huaja/masa sigurimi personal caktuar nga autoritetet e huaja /shpallur në kërkim ndërkombëtar/procedime penale të regjistruara jashtë territorit të Shqipërisë, për shtetasin Genti Nesip Ibrahim, i datëlindjes 20.03.1970; ... ju informojmë se nga kontrolli i ushtruar nga Zyra e Protokoll Arkivës, nuk rezultojnë të dhëna.... Lidhur me kërkesën nëse këta shtetas, kanë pasur identitet të ndryshëm nga ai që mbajnë aktualisht, ju informojmë se ky informacion nuk disponohet nga ana jonë".

32.2. Ndërsa me shkresën 669/1 prot., datë 06.04.2022, Prokuroria e Përgjithshme, ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, si vijon: "Në përgjigje të kërkesës për informacion nëse nga ana jonë disponohen të dhëna për dënime penale nga autoritetet gjyqësore të huaja/masa sigurimi personal caktuar nga autoritetet e huaja /shpallur në kërkim ndërkombëtar/procedime penale të regjistruara jashtë territorit të Shqipërisë, për shtetasin Genti Nesip Ibrahim, i datëlindjes 20.03.1970; ...ju informojmë se nga verifikimet e kryera nga Zyra e Protokoll Arkivës dhe në sistemin IMPRO, nuk disponojnë të dhëna. Lidhur me kërkesën nëse këta shtetas, kanë pasur identitet të ndryshëm nga ai që mbajnë aktualisht, ju informojmë se ky informacion nuk disponohet nga ana jonë".

33. Gjithashtu, për verifikimin e integritetit, të lidhur me pastërtinë e figurës dhe të gjendjes gjyqësore të kandidatit Genti Ibrahim, në zbatim të shkronjës "ç" të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Drejtësisë”, KED i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 123 prot., datë 02.03.2022*); me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 124 prot., datë 02.03.2022*); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (*shkresa nr. 302 prot., datë 16.03.2022*); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (*shkresa nr. 301 prot., datë 16.03.2022*); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*shkresa nr. 315 prot., datë 18.03.2022*).

33.1. Me shkresën nr. 1197 prot., datë 14.04.2022, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, i ka kthyer përgjigje Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke bërë me dije se: *“...Në përfundim të procedurave të verifikimit, na informojnë se nuk disponohen të dhëna për përfshirjen e z. Genti Nesip Ibrahimit në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme...”*.

33.2. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje, me shkresën nr. 439/1 prot., datë 07.03.2022, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Genti Ibrahimit: *“nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale”*.

33.3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 1181/4 prot., datë 23.04.2022, është përgjigjur se: *“...pasi u kryen verifikimet rezultoi shtetasit:6. Genti Nesip Ibrahimit, i datëlindjes 20.03.1970, me nr. personal H00320090S, -Nuk figurojnë të ndaluar/arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit për ndonjë vepër penale; -Nuk kanë gjeneralitete të tjera të regjistruara në sistemet e policisë; -Nuk rezultojnë të jenë dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër dhe nuk janë në kërkim ndërkombëtar...”*.

33.4. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 3262/1 prot., datë 18.03.2022, është përgjigjur se: *“sipas të dhënave të dërguara nga ana juaj, ju informojmë se shtetasit e dërguar në listën emërore nga 1-9, rezultojnë të padënuar nga gjykata penale Shqiptare”*. Bashkëlidhur kësaj shkrese është vendosur vërtetimi i gjendjes gjyqësore me nr. 11 prot., datë 23.03.2022 për shtetasin Genti Nesip Ibrahimit, me shënimin *“është i padënuar”*.

33.5. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 2746/1 prot., datë 29.03.2022, është përgjigjur se: *“Shtetasi Genti Ibrahimit... nuk ka ndryshime”*.

35. Lidhur me *masat disiplinore*, KED vlerësoi t'i drejtohet me kërkesë për informacion institucioneve mbështetur në të dhënat në dosjen e kandidimit lidhur me funksionin publik dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*shkresa nr. 273 prot., datë 11.03.2022*).

34.1. Me shkresën nr. 609/1 prot., datë 28.03.2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka njoftuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se: *“...deri tani Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka miratuar asnjë kërkesë për procedim disiplinor ndaj kandidatëve të sipërpërmendur (me sipër-cituar z. Genti Ibrahimit)...”*.

34.2. Me shkresën nr. 1206/1 prot., datë 19.07.2022, Kuvendi i Shqipërisë i ka vënë në dispozicion Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aktin e emërimit të kandidatit Genti Ibrahimit si anëtar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (konkretisht vendimin nr. 122, datë

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

24.09.2007). Edhe pse i është kërkuar dhe koha e mbarimit të mandatit, ky institucion nuk ka kthyer përgjigje në këtë drejtim.

34.3. Me shkresën nr. 1762/2 prot., datë 03.06.2022, lëshuar nga Departamenti i Mirëadministrimit në Kryeministri, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i është përcjellë Urdhëri me nr. 58, datë 29.06.1999 të Kryeministrit, sipas të cilit është pasqyruar se: "...Z. Gent Ibrahimit, me detyrën Shef Kabineti pranë Ministrisë të Shtetit për reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Parlamentin, në aparatën e Këshillit të Ministrave, lirohet nga detyra me kërkesë të tij..."

34.4 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi edhe pse ka kërkuar informacion në lidhje me faktin nëse kandidati Gent Ibrahimit ka pasur ose jo masa disiplinore pranë institucioneve ku ka ofruar veprimtarinë e tij profesionale, sipas akteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultojnë të jenë përfunduar të dhëna që tregojnë në mënyrë direkte se ai ka pasur masa disiplinore. Rezulton se kandidati Gent Ibrahimit, në datën 19.12.2018 është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, një nga kriteret e të cilit ka qenë mospasja e masave disiplinore (neni 149/3 i Kushtetutës dhe neni 134/dh i ligjit nr.115/2019, sipas të cilit kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi); ç'ka prezumon faktin se ky kandidat nuk ka pasur masa disiplinore në fuqi gjatë kohës që ka kandiduar si anëtar i KLP-së. Gjithashtu, ky kandidat sipas akteve të administruara në dosje, nuk rezultojnë të ketë marrë masa disiplinore gjatë veprimtarisë së tij profesionale.

35. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me shkresën nr. 110 prot., datë 28.02.2022, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Gent Ibrahimit për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

36. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 321/3 prot., datë 11.03.2022, ka dërguar vendimin nr. 63, datë 10.03.2022 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Arta Marku, duke ardhur përfundimet se: "Zonjat dhe zotërinjtë ...6. Genti Ibrahimit..., (i) nuk kanë qenë persona në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; (ii) Nuk kanë qenë anëtar bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit; (iii) Nuk figurojnë të ketë materiale në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

v. VERIFIKIMI I PASURISË

37. Neni 125, pika 5 e Kushtetutës parashikon se kriteret e tjera për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Neni 7/a pika 1 shkronja "dh" e ligjit nr. 8577/2000, parashikon si kusht kandidimi kalimin me sukses nga kandidati të procesit të kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

38. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së nëpërmjet shkresës me nr. 108 prot., datë 28.02.2022, listën e kandidatëve dhe

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar.

39. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, po në datën 28.02.2022, nëpërmjet njoftimit elektronik (i cili është i administruar në dosje) i ka bërë me dije kandidatit Genti Ibrahimimi se: *“Me anë të këtij njoftimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ju vë në dijeni se ditën e sotme është përcjellë pranë ILDKPKI-së lista e candidateve së bashku me dokumentacionin e dorëzuar nga ana Juaj, që lidhet me procedurën e verifikimit të pasurisë, të kandidatëve për vendin vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të përfundimit të mandatit, të gjyqtarit Përparim Kalo, vakancë për të cilën keni shprehur edhe ju interes për kandidim. Për sa më sipër jeni të lutur të paraqiteni pranë këtij institucioni për vijimin e procedurës...”*.

40. Në datën 03.03.2022, kandidati ka depozituar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi edhe autorizimin e djalit të tij Tedi Ibrahimimi, si person i lidhur me të për efekt të kontrollit të pasurisë. Ky autorizim është administruar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me proces-verbalin nr. 102/1 prot., datë 03.03.2022 dhe është nënshkruar si nga kandidati Genti Ibrahimimi, ashtu edhe nga punonjësi i administratës së KED.

41. Me shkresën nr. 176 prot., datë 04.03.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka dërguar ILDKPKI-së listën e personave të lidhur me kandidatin që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar.

42. Me shkresën nr. 1018/2 prot, datë 25.03.2022, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se: *“...Inspektorati i Lartë për të gjithë kandidatët e listuar në shkresë mori masa për krijimin e llogarive në sistemin EACIDS.... Kanë dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë, të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë”, kandidatët e mëposhtëm:4. Genti Ibrahimimi...”*.

43. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 1018/6 prot., datë 18.05.2022, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Aktin Përfundimtar nr. 733/24 Prot., datë 18.05.2022 dhe rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Genti Ibrahimimi, ku në përfundim të analizës së hollësishme financiare konkludon se:

a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mosdeklarime të interesave privatë ndër vite.

b) Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat, që kanë shërbyer si burim i pjesshëm për krijimin e pasurive.

c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.

ç) Nuk ka kryer deklaram të rremë.

d) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

44. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësisë së kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi janë kryer edhe veprime të tjera verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Gent Ibrahimimi dhe personave të lidhur me të.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : *info@ked.gov.al* Numra telefonikë : *+355 4 2257302*

45. Konkretisht, KED, në datat 02.03.2022, 11.03.2022, 30.03.2022, 31.05.2022, 02.06.2022, 07.06.2022, 24.06.2022, dhe 29.06.2022, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka Societe Generale, (11) Banka Tiranë dhe (12) Banka Union, (13) Banka Ndërkombëtare Tregtare.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë: (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k, (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Tirana Factoring & Lease, (15) Tranzit sha, (16) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal, (9) ABI INVEST, (10) ALBSIG INVEST, (11) Final sh.p.k.
- ç) Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtesisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

45.1 Në përgjigje të kërkesave për informacion, institucionet publike dhe subjektet private të listuara më sipër, (përveç Banka Ndërkombëtare Tregtare⁴ dhe Banka e Kreditit të Shqipërisë⁵), kanë dërguar përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Gent Ibrahimit.

45.2 Duhet theksuar se lidhur me komunikimin me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, informacioni nuk ka ardhur i plotë dhe në kohë nga ky institucion, pas shkresës së fundit të KED, të datës 29.06.2022, (ASHK është e organizuar në 24 drejtori dhe 21 zyra vendore kadastrale), janë plotësuar përgjigjet edhe për disa nga drejtoritë dhe zyrat vendore të Kadastrës Shtetërore. Megjithatë sipas vendimmarrjes së fundit të KED, datë 24.06.2022, u vendos që në kushtet kur ky institucion nuk po përgjigjej në kohë, edhe pse do t'i drejtoheshim sërish, do të duhej, që me qëllim përshpejtimin e këtij procesi, të merrej informacioni në mënyrë të tërthortë nga hetimi i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit në këtë drejtim dhe të verifikohesh nëse ishte bërë hetimi i thelluar për pasuritë e paluajtshme përmes ASHK-online. Po ashtu ia vlen të theksohet se gjatë muajit Gusht-Shtator 2022, disa Drejtori dhe Zyra Vendore të ASHK kanë kthyer përgjigje në lidhje me kandidatin Gent Ibrahimit, të cilat janë administruar në dosje.

45.3 Me shkresën nr. 495 prot., datë 24.06.2022, iu kërkua ILDKPI, dosja e kandidatit, e cila na u vu në dispozicion me shkresën nr. 2288/1 prot, të datës 01.07.2022. Sipas dokumentacionit dhe akteve të administruara në këtë dosje, rezulton se ky institucion ka kryer verifikime në sistemin ASHK online për kandidatin dhe personat e lidhur me të, sa i përket

⁴ Bankë, e bashkuar me BANK UNION SHA.

⁵ Banke, e cila është në proces likuidimi.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

pasurive të paluajtshme dhe objekteve në legalizim. (fq 1616 -1969 (gjithsej 353 faqe) e dosjes së ILDKPI, printuar dhe administruar në dosjen e KED për kandidatin).

46. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi pasi është njohur me raportin përfundimtar të hartuar nga ILDKPI për kandidatin Genti Ibrahim, në datën 20.05.2022, nëpërmjet formës elektronike i ka bërë me dije këtij kandidati se: "...ILDKPKI, me shkresën nr. 733/24 prot, date 18.05.2022 ka dërguar pranë KED, Aktin e Përfundimit të Kontrollit të Plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë për kandidaturën tuaj. ILDKPKI, lidhur me periudhën e verifikuar ka ardhur në përfundimin:

- a) Mosdeklarim i shitjes së pasurisë së paluajtshme në Vlorë, konkretisht të apartamentit me sip. 114,1 m2, me çmim 51.000 euro dhe apartamentit me sip 89,66 m2, me çmim 45.000 euro, në deklaratën e interesave private "Periodike vjetore 2019", si dhe i shitjes së njësisë me sip.41 m2, me çmim 3.800.700 lekë në deklaratën e interesave "Periodike vjetore 2020", pasuri të përfituara me kontratë shkëmbimi nr. 1811 rep., nr. 1143 kol., datë 06.09.2019, e cila nuk është paraqitur nga kandidati;
- b) Mosdeklarim në deklaratat e interesave private ndër vite, i detyrimeve të mbartura/shlyerjeve ndaj shoqërisë Armada sh.p.k., deri në likuidimin e çmimit të plote të viles C7;
- c) Mungese dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me diferencën e çmimit të shitjes së apartamentit me sip. 95 m2 në rrugën "Komuna e Parisit" Tirane, në vitin 2002 dhe shumës së përfitur nga blerësi, që sipas sqarimeve të kandidatit i përket mobilimit të këtij apartamenti.
- d) Mungese dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e kandidatit, të përfituara nga honoraret, konsulencat, dhe nga punësimi në organizatat e huaja.
- e) Kandidati nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave private periodike "Periodike vjetore 2020", pjesën takuese prej 1/3, në pasurinë truall me sip. 840m2, Vlore, regjistruar me dt .20.08.2020, përfitur me dëshmi trashëgimie.....

Në zbatim të nenit 229 pika 2 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 26, 66, 67 dhe 68 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", keni të drejtën që, brenda një **afati 5 ditor** nga ky njoftim të paraqisni shpjegime me shkrime dhe eventualisht dokumente mbështetës drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë.

Nëse vlerësoni se keni të nevojshme të konsultoheni me Aktin e Kontrollit të ILDKPKI pranë KED, mund të paraqiteni në kohën më të shpejtë të mundshme pranë zyrave të Këshillit për të marrë kopje fizike. Lutemi të konfirmoni marrjen dijëni të këtij njoftimi në të njëjtën adresë elektronike të këtij komunikimi.....".

47. Në datën 24.05.2022, kandidati i është drejtuar në formë elektronike Këshillit të Emërimeve në drejtësi, duke i bërë me dije se: "...në vijim të komunikimit të mësipërm po ju dërgoj, bashkëlidhur, shpjegimet dhe komentet e mia mbi raportin e ILDKPKI. Gjithashtu po ju dërgoj edhe një dokument me 5 faqe që përmendet në raportin e ILDKPKI (kontratë shkëmbimi)....".

48. Në aktin shkresor drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kandidati ka dhënë këto shpjegime:

1. **Në lidhje me konstatimin e parë të ILDKPKI.** Pasuritë në fjalë janë përfitur si rrjedhojë e kontratës së sipërmarrjes me "Brilant" shpk për ndërtim objekti mbi tokën e trashëguar nga kandidati. Për të vërtetuar sa më sipër kam dorëzuar në ILDKPKI Kontratën e Sipërmarrjes Nr. 851 Rep, Nr. 527 Kol, datë 08/06/2020 dhe Akt Marrëveshjen për

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Caktimin e Pjesës në Natyrë të Palës Pronare të Truallit Nr. 1269 Rep. Nr. 92 Kol, datë 17.06.2016. Kontratën e Shkëmbimit nr. 1811 Rep. Nr.1143 Kol, datë 6.9.2019 e cila nuk është paraqitur në momentin e deklarimit, (pasi nuk e disponoja në atë kohë) po ia bashkëngjis këtij e-maili. Shitjet e pasurive të përmendura janë deklaruar rregullisht në kuadër të deklarimit për efekt kandidimi. Gjithashtu kontratat e shitjes janë depozituar në ILDKPKI qoftë gjatë kontrollit të thelluar në fund të vitit 2021, qoftë në kuadër të kontrollit për efekt të deklarimit. Mos deklarimi i shitjes së këtyre pronave në Deklaratat Periodike Vjetore të viteve 2019 dhe 2020 shpjegohet me faktin se këto prona, deri në fund të vitit 2019, figuronin në emër të nënës. Pasi ajo ndërroi jetë në maj të vitit 2019, këto prona kaluan në bashkëpronësi midis kandidatit, babait dhe motrës së kandidatit. Për më tepër shitjet janë bërë me prokurë nga babai dhe të ardhurat janë derdhur në llogarinë e tij. Në këto kushte mosdeklarimi i shitjeve ka qenë një pasaktësi/harresë.

2. ***Në lidhje me konstatimin e dytë të ILDKPKI.*** Fjala është për shtëpinë ku unë banoj aktualisht. Kjo shtëpi është deklaruar nga unë që në deklarimin tim të parë në vitin 2007 (në atë kohë isha anëtar i Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit). Deklarimi është shoqëruar gjithnjë nga Kontrata e Porosisë dhe (duke filluar që nga viti 2009) edhe nga kontrata e shitjes. Fakti që në deklaratat e viteve 2007 dhe 2008 unë nuk kam deklaruar në rubrikën "Detyrimet Financiare ndaj Personave Juridikë dhe Fizikë" shumat që i detyroheshka shoqërisë ndërtuese sipas kontratës së porosisë ka pasur të bëjë me keqkuptimin e qëllimit të kësaj rubrike e cila, teksa shpjegonte se çfarë janë detyrimet financiare që duhen deklaruar, jepte si shembuj (i) kreditë, (ii) huamarrjen, (iii) detyrim për studime etj. Duke mos u ndodhur në asnjërën prej situatave të mësipërme (thjesht kisha porositur një shtëpi paratë për të cilën i kisha në llogari bankare) nuk e kam kuptuar që duhej të deklaroja shumat që i detyroheshka ndërtuesit sipas kontratës së porosisë dhe pagesat që bëheshin periodikisht sipas kalendarit të punimeve. Shtoj gjithashtu që kjo e metë nuk është vënë asnjëherë në dukje nga ILDKPKI;
3. ***Në lidhje me konstatimin e tretë të ILDKPKI.*** Vlera reale e shitjes së apartamentit në vitin 2002 është deklaruar saktësisht. Të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit të dytë që është ende në pronësi të kandidatit. Fakti që kontrata e shitjes tregonte një shifër të ndryshme nga shifra e përfutur nga shitja dhe e deklaruar kishte të bënte me një marrëveshje midis shitësit dhe blerësit për të veçuar vlerën e apartamentit nga vlera totale e shitjes e cila, përveç apartamentit, përfshinte edhe mobilimin dhe një vend parkimi.
4. ***Në lidhje me konstatimin e katërt të ILDKPKI.*** Duke filluar nga viti 1999 deri në vitin 2018 kam qenë i punësuar pranë Institutit për Studime Publike dhe Ligjore (herë si drejtor e herë si specialist). Duke qenë se gjatë gjithë kësaj periudhe nuk kam qenë subjekt tatimor si individ nuk kam ruajtur dokumentacion që të tregojë shlyerjen e detyrimeve tatimore. **Jam në pritje të një vërtetimi nga tatimet që nuk jam debitor.**
5. ***Në lidhje me konstatimin e pestë të ILDKPKI.*** Ju lutem vini re se struktura e pasurive të mia të paluajtshme është mjaft komplekse. Në deklaratën time të pasurisë do të gjeni 45 pasuri të paluajtshme. Të gjitha (me përjashtim të shtëpisë ku banoj) janë të trashëguara. Shumë prej tyre as i kam parë e as i kam shkelur ndonjëherë. Shumë prej këtyre pasurive për mua nuk janë veçse letra. Në këto kushte nuk është për t'u habitur që të ketë ndonjë harresë si kjo aq më tepër që gjatë 3 muajve të fundit kam kryer 4 deklarime dhe kontrole: (i) kontrolli i thelluar në fund të vitit 2021; (ii) deklarimi pas përfundimit të detyrës; (iii) deklarimi periodik për vitin 2021; (iv) deklarimi dhe kontrolli për efekt kandidimi. Tre deklaratimet e fundit kanë pasur edhe vështirësinë shtesë të përdorimit, për herë të parë, të sistemit elektronik.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

49. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me qëllim verifikimin e plotë dhe të gjithanshëm për verifikimin e pasurisë së kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese i është drejtuar me shkresën nr. 127, prot., datë 02.03.2022 dhe atë më nr. 171 prot., datë 04.03.2021, (shtuar djalin, si person i lidhur), Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve në lidhje me të ardhurat dhe të dhënat tatimore të kandidatit Gemti Ibrahimimi si dhe personave të tij të lidhur.

49.1. Me shkresën nr. 3588/1 prot., datë 15.03.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Hetimit Tatimor ka bërë me dije se: "...16. Genti Nasip Ibrahimimi, i datëlindjes 20.03.1970, identifikuar me nr. ID H00320090S rezulton i regjistruar: -si administrator në subjektin Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore (OJF) me Nipti K42004009S. Bashkëlidhur informacioni i përgjithshëm, personat që lidhen, detyrimet në kohë reale, nuk ka deklarata të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Nuk ka deklarata të TAPBV. Bashkëngjitur historiku i punonjësit dhe e-sig 2. Bashkëngjitur kontrata e qirasë, në sistem nuk ka të dhëna për tatimin në burim të qirasë. 17. Alba Pjerin Ibrahimimi, e datëlindjes 17.07.1969, identifikuar me ID G96202034E nuk ka të dhëna në lidhje me aktivitet ekonomik të regjistruar në organin tatimor. Bashkëlidhur kopje ekstrakt lista e subjekteve të personave tatimpagues të lidhur".

49.2. Me shkresën nr. 3810/1 prot., datë 24.03.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Hetimit Tatimor, Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës, ka bërë me dije se: "...1. Genti Nasip Ibrahimimi, i datëlindjes 20.03.1970, identifikuar me nr. ID H00320090S rezulton të ketë qenë administrator i subjektit "Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore" (OJF) me Nipti K42004009S, për periudhën deri në datë 04.01.2019. Për këtë subjekt ju dërgojmë bashkëlidhur kopje-ekstraktet, informacioni i përgjithshëm, persona që lidhen, pasqyrat financiare 2014-2019, historiku i punonjësve, formulari E-sig025, ku pasqyrohen pagat bruto të çdo muaji të aktivitetit; kontratat e qirasë, detyrimet në kohë reale. Nuk dorëzohen deklarata tatim-fitim pasi është OJF. Për shtetasin Gent Ibrahimimi ju dërgojmë bashkëlidhur ekstraktin historik të punonjësit. Është subjekt i deklarimit individual të të ardhurave, Bashkëlidhur deklaratat e të ardhurave për vitet 2019-2020. 2 Alba Pjerin Ibrahimimi, e datëlindjes 17.07.1969, identifikuar me ID G96202034E nuk rezulton të ketë ose të ketë patur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të saj. Bashkëlidhur kopje ekstrakti "Lista e subjekteve të personave/tatimpagues të lidhur" dhe ekstrakti historik i punonjësit. Është subjekt i deklarimit individual të të ardhurave. Bashkëlidhur deklaratat e të ardhurave për vitet 2011-2012 3. Tedi Genti Ibrahimimi, i datëlindjes 08.02.1996, identifikuar me ID J60208065F nuk rezulton të ketë ose të ketë patur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të tij. Bashkëlidhur kopje ekstrakti "Lista e subjekteve të personave/tatimpagues të lidhur". Rezulton i punësuar. Bashkëlidhur ekstrakti historik i punonjësit. Nuk kryen deklarim individual të të ardhurave...".

49.3 Kandidati, nëpërmjet rrugës elektronike në datën 08.06.2022, i ka përcjellë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vërtetimin, i cili nuk përmbante ekstremitetet e nevojshme të një dokumenti zyrtar të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë.

49.4 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi pasi është njohur me dokumentacionin e dërguar nga kandidati Genti Ibrahimimi, po në datën 08.06.2022, në rrugë elektronike i ka bërë me dije këtij subjekti se akti duhej dërguar në formën e kërkuar nga ligji.

49.5 Kandidati në datën 10.06.2022 është paraqitur në zyrën e protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke depozituar disa akte shkruese, njëra prej të cilave ishte edhe vërtetimi me nr. 14154/1 prot., datë 08.06.2022 i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nëpërmjet të cilës është pasqyruar se: "...referuar të dhënave që disponojmë në Drejtorinë Tatimore Tiranë, deri në datën e sotme, vërtetojmë se Z. Genti Nesip Ibrahimimi me ID

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA ELARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

H00320090S ka paguar të gjitha detyrimet tatimore mbi të ardhurat nga punësimi, konsulencat dhe honoraret e deklaruara në vitin 2020. Lidhur me këto të ardhura nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datën 07.06.2022...". Ky dokument është administruar nëpërmjet proces-verbalit me nr. 490 prot., datë 10.06.2022, i nënshkruar nga kandidati dhe punonjësi i zyrës së protokollit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Po ashtu kandidati e ka dërguar këtë dokument edhe me e-mailin e datës 17.06.2022.

49.6 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, bazuar në aktet e administruara në dosje, korrespondencës së mbajtur me organin tatimor, konkluzioneve të nxjerra nga raporti përfundimtar i kontrollit të hartuar nga ILDKPI, si dhe prapësimeve të dhëna nga ana e kandidatit Genti Ibrahim, bazuar në pikën 68, shkronja "a", të Vendimit nr.4/2019 të KED, në datën 24.06.2022 i është ridrejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 493 prot., datë 24.06.2022, nëpërmjet të cilës ka kërkuar informacion në lidhje me këto çështje:

- *Informacioni që ju i keni kthyer Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me shkresën nr. 3810/1 prot., datë 24.03.2022 nuk rezulton të jetë i plotë dhe ezaurues. Nga akti i kontrollit të hartuar nga ILDKPI ka rezultuar se kandidati Genti Nesip Ibrahim ka deklaruar për pasurinë që disponon, se ka siguruar të ardhura nga pagat, honoraret dhe konsulencat e ndryshme të dhëna për organizata jofitimprurëse apo organizata ndërkombëtare.*
- *Sipas kontratave që kandidati ka paraqitur pranë ILDKPI-së, të cilat, datojnë të paktën që nga viti 2012 e vijim, në disa prej tyre ka rezultuar se detyrimet tatimore ndaj shtetit i ka pasur vetë kandidati (në rolin e konsulentit, ekspertit). Në lidhje me këtë fakt, kërkojmë nga ana juaj që të na sqaroni në lidhje me këto çështje:*

1) Sa detyrime tatimore ka paguar kandidati Gent Nesip Ibrahim për të ardhurat e realizuara nga viti 2012 e në vijim, si tatimpagues, referuar faktit që të ardhurat e realizuara prej tij në këtë periudhë mund të kenë qenë mbi 2.000.000 (dy milion lekë) dhe ju keni vënë në dispozicion të KED vetëm deklaratat e të ardhurave për vitet 2019-2020?

Sipas shkresës suaj me nr. 3810/1 prot., datë 24.03.2022, kandidati Gent Ibrahim është subjekt i deklarimit individual të të ardhurave dhe në lidhje me këtë fakt, a ka dorëzuar deklaratë për vitin 2021 (DIVA)?

Ky informacion është i nevojshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për sa kohë kandidati për anëtar të Gjykatës Kushtetuese ka shprehur interes për të kandiduar për këtë pozicion në datën 04.02.2022, periudhë e cila përfshihet në verifikimin e kruterit të pasurisë. Për më tepër, që nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi mbahet në vëmendje fakti se, afati i dorëzimit të deklaratës për të ardhurat gjatë vitit 2021 ka qenë deri në datën 30.04.2022, pra, kohë pasi ju keni sjell informacionin me shkresën nr. 3810/1 prot., datë 24.03.2022.

- *Gjithashtu, në raportin përfundimtar të kontrollit me nr. 1018/6 prot., datë 18.05.2022, nga ana e ILDKPI është arritur në konkluzionin se: "...Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e kandidatit nga honoraret, konsulencat dhe nga punësimi në organizatat e huaja... Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat, që kanë shërbyer si burim i pjesshëm për krijimin e pasurive...". Ndërsa, me vërtetimin nr. 14154/1 prot., datë 08.06.2022 të lëshuar nga ana juaj, me kërkesë të kandidatit Gent Ibrahim, ju keni pasqyruar se: "...referuar të dhënave që disponojmë në Drejtorinë Rajonale Tatimore deri në ditën e sotme, vërtetojmë se Genti Nesip Ibrahim me ID H00320090S ka paguar të gjitha detyrimet tatimore mbi të ardhurat nga punësimi, konsulencat dhe honoraret e deklaruara deri në vitin 2020. Lidhur me këto të ardhura nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri në datën 07.06.2022...".*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

- Sa më sipër, për efekte të hetimit administrativ kërkohet nga ana juaj që të na konfirmoni dhe të jepni sqarime të qarta në lidhje me faktin se:
 - (i) A ka pasur kandidati Gent Ibrahimimi detyrime tatimore të pashlyera deri në datën 18.05.2022, kohë në të cilën ka dalë raporti përfundimtar i kontrollit të ILDKPI?
 - (ii) Nëse kandidati Genti Nesip Ibrahimimi ka pasur detyrime tatimore të pa shlyera, sa ka qenë kjo vlerë, kur janë paguar ato prej tij si dhe për cilin zë të të ardhurave janë paguar ato (qira, konsulenca, mësime etj)?
Për këtë informacion na vini në dispozicion dokumentacionin përkatës.
 - (iii) Cila është korrespondenca që keni mbajtur me institucionin e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI), deri në datën 18.05.2022, në lidhje me verifikimin e të ardhurave të krijuara nga shtetasi Genti Nesip Ibrahimimi nga pagat, honoraret, shërbimet e konsulencës etj, si dhe pagimin prej tij të detyrimeve tatimore në lidhje me këto të ardhura për secilin vit, për efekt të këtij kandidimi?
Për këtë informacion na vini në dispozicion të gjithë korrespondencën e mbajtur me ILDKPI për efekt të verifikimit të pasurisë së këtij shtetasi, për këtë proces.

49.7 Me shkresën nr. 17537/1 prot., datë 06.07.2022, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, i ka kthyer përgjigje Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në lidhje me çështjet e adresuara, duke bërë me dije se:

- i) Në lidhje me kërkesën tuaj: sa detyrime tatimore ka paguar kandidati Gent Nesip Ibrahimimi për të ardhurat e realizuara nga viti 2012 e në vijim, ju informojmë se sipas regjistrimeve në sistemin informatik të tatimeve deri në datën e sotme, rezulton situata si më poshtë:
 - Nga listëpagesat e dorëzuara në sistemin informatik të tatimeve nga subjektet punëdhënës rezulton se, për të ardhurat bruto nga paga të deklaruara sipas këtyre listëpagesave për individin Genti Ibrahimimi me ID FI00320090S, tatimi mbi këto të ardhura është mbajtur dhe paguar nga secili subjekt punëdhënës sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 10 ligjit nr. 8438/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat ", i ndryshuar, për vlerat si më poshtë:

Subjekti punedhenes	Periudha	Paga bruto vjetore	TAP
Inst. Studimeve publike dhe	Janar-dhjetor2012	410,000	30,000
Inst. Studimeve publike dhe	Janar-dhjetor2013	960,000	96,000
Inst. Studimeve publike dhe	Janar-dhjetor2014	630,591	48,795
Inst. Studimeve publike dhe	Janar-dhjetor2015	1,218,215	124,747
Inst. Studimeve publike dhe	Janar-dhjetor2016	1,282,880	125,100
Inst. Studimeve publike dhe	Janar-dhjetor2017	1,172,800	105,664
Shkolla Magjistratures	maj; korrik2017	39,000	
	Totali viti 2017	1,211,800	105,664
Inst. Studimeve publike dhe ligjorç	Janar-dhjetor2018	1,080,000	93,600
Shkolla Magjistratures	Shkurt. mars, prill.korrik.dhjetor 2018	221,100	9,750
	Totali viti 2018	1,301,100	103,350
Keshilli i Larte i Prokurorise	janar-dh jetor2019	3,723,317	629,559
Shkolla Magjistratures	shkurt, maj.korrik 2019	69,300	2,535
	Totali viti 2019	3,792,617	632,094

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA ELARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri
Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Keshilli i Larte i Prokurorise	janar-dhjetor2020	3.664.884	616.122
Shkolla Magjistratures	Prill,shtator 2020	51.150	1.892
	Totali viti 2020	3.716.034	618.014
Keshilli i Larte i Prokurorise	janar-dhjetor 2021	3,693,228	622,644
Shkolla Magjistratures	dhjetor 2021	121,275	11,866
	Totali viti 2021	3.814.503	634,510

- Shtetasi Genti Ibrahim me ID H00320090S në datën 30.07.2020 është regjistruar ne sistemin tatimor si individ me përgjegjësinë tatimore "Tatimi mbi te ardhurat individuale" dhe ka dorëzuar "Deklaratat Individuale të të Ardhurave", për periudhat si më poshtë:

Viti	Pershkrimi i te Ardhurave	Vlera e te ardhurave bruto te deklaruar	Vlera e tatimit te llogaritur	Vlera e tatimit te deklaruar te paguar gjate vitit	Vlera e tatimit te rezultuar per t'u paguar me deklarate n	Data e pagesës per detyrimin (principal) te rezultuar per t'u paguar me
2017	Te ardhura bruto te tjera	3,288,000	493,200	0	493,200	2017
Totali i deklaruar sipas DIVA2017 (e dorëzuar ne daten 02.06.2022)		3,288,000	493,200	0	493,200	03.06.2022
2019	Të ardhurat bruto nga paga apo shperblime nga marrëdhëniet e punesimit	3,723,317	629,559	629,559		
	Te ardhura bruto nga qiraja	690,000	90,000	90,000	0	
Totali i deklaruar sipas DIVA2019 (e dorëzuar ne daten 30.07.2020)		4,413,317	719,559	719,559	0	
2020	Te ardhurat bruto nga paga apo shperblime nga marrëdhëniet e punesimit	3,716,034	627,887	627,887	0	
	Te ardhura	8,000,000	1,200,00	1,200,00	0	

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

	bruto nga qiraja		0	0		
Totali i deklaruar sipas DIVA2020 (e dorezuar ne daten 30.04.2021)		11,716,034	1,827,887	1,827,887	0	0
2021	Te ardhurat bruto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit	3.814,503	650,537	650,537		
Totali i deklaruar sipas DIVA 2021 (e dorezuar ne daten 08.04.2022)		3,814,503	650,537	650,537	0	0

- Sqarojmë se deri në datën e sotme në DRT Tiranë nuk disponojmë të dhëna të tjera për të ardhura personale të përfituara nga Genti Ibrahimimi me ID H00320090S përveçse të dhënave për pagën bruto sipas listëpagesave në sistemin informatik të tatimeve si dhe në vlerat e vetëdeklaruarave me "Deklaratat Individuale Vjetore" të dorëzuara nga ky individ si më sipër.
- Bazuar në këto të dhëna dhe sipas përcaktimit në pikën 4 të nenit 13 të Ligjit nr. 8438/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky individ ka pasur detyrimin ligjor për dorëzimin e deklaratave individuale vjetore vetëm për vitet 2017, 2019, 2020 dhe 2021.
- Përsa i përket deklaramit për të ardhurat nga paga dhe tatimin e llogaritur dhe TAP të paguar gjatë vitit sipas deklaratave të dorëzuara për vitet 2017, 2019 dhe 2020, për pasaktësi të konstatuara krahasuar me të dhënat sipas listëpagesave dhe llogaritjen e tatimit për të ardhurat totale për periudhat e përfituara nga dy punëdhënës të ndryshëm sipas përcaktimit në pikën 4 të nenit 13 të ligjit nr. 8438/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, nga ky individ është kërkuar saktësimi i deklaratave me kërkesën nr. 14570 prot., data 07/06/2022.
- Me kërkesën e individit dhe bazuar në verifikimin si më sipër nga DRT Tiranë është kryer saktësimi i këtyre deklaratave me nr. 14570/1 prot., data 07/06/2022, pas të cilit rezultuan detyrimet për t'u paguar si më poshtë:

Viti	Detyrim principal	Gjobë për deklaram të pasaktë	Gjobë pagesë e vonuar	Kamatëvonesa	Totali
2017	5,070	1,110	1,110	1,191	8,481
2019	13,408	2,936	2,936	1,355	20,635
2020	9,873	2,026	2,020	499	14,418
totali	28,351	6,072	6,066	3,045	43,534

- Për detyrimet e rezultuara si më sipër tatimpaguesit i është dërguar Njoftim-vlerësimi për detyrime nr. 14570/1 prot., data 07/06/2022 dhe sipas të dhënave të regjistruara në sistem ky tatimpagues ka kryer pagesën e këtyre detyrimeve në datën 07.06.2022.
- Ndërsa për detyrimin principal 493.200 lekë të rezultuar nga deklarata DIVA2017 e

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

dorëzuar nga ky tatimpagues në datën 02.06.2022 për tatimin e llogaritur me 15% për të ardhurat bruto prej 3.288.000 lekë të deklaruar në rubrikën 14] "Të ardhura bruto të papërmendura me lart" (rubrikë e cila përfshin pagesa të përfituara për honorarë .. etj.) pagesa është kryer në datën 03.06.2022 dhe për gjobat 5.000 lekë për deklarim të vonuar dhe 228,876 lekë gjoba, kamatevonesa për pagesë të vonuar lidhur me këtë detyrim pagesa është kryer në datën 06.06.2022.

- Për sa më sipër sqaruam, në datën 08.06.2022 kur këtij tatimpaguesi i është lëshuar nga DRT Tiranë vërtetimi me nr. 14154/1 prot., nuk rezultonin detyrime të papaguara lidhur me të ardhurat bruto nga paga dhe honorare të deklaruar sipas deklaratave të dorëzuara për periudhat deri në vitin 2020.
 - Ndërsa për tatimet e deklaruar të paguara gjatë vitit lidhur me të ardhurat e deklaruar nga qiraja sipas "Deklaratave Individuale Vjetore të të Ardhurave" të dorëzuara nga ky individ për vitet 2019 dhe 2020, me shkresën tonë nr. 14154/1 prot. me lëndë "Kthim përgjigje dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni", drejtuar Z. Genti Ibrahimimi me ID H00320090S i është kërkuar dokumentacioni vërtetues sipas përcaktimit të UMF nr. 5, data 30.01.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pika 2.8.6.1 gërmat d), Kopje të kontratave të qirasë për të ardhurat bruto nga qiraja të deklaruar dhe dokumentin që vërteton pagesën e tatimit të deklaruar të paguar gjatë vitit lidhur me këto të ardhura, por deri në datën e sotme nuk është paraqitur ky dokumentacion.
 - Për sa i përket DIVA 2021 për të cilën nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera 650.537 lekë e pasqyruar në rubrikën [22] të kësaj deklarate nuk përputhet me vlerën prej 634.510 lekë tatimit për të ardhurat nga punësimi të paguar gjatë vitit sipas listëpagesave, individi është njoftuar për verifikimin dhe mundësinë për dorëzimin e deklaratës së ndryshuar brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 2 të nenit 13/1 të Ligjit nr. 8438/2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.
- (ii) Për kërkesën tuaj lidhur me korrespondencën me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave, sqarojmë se në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë nuk kemi korrespondencë me ILDKPI për shtetasin Genti Nasip Ibrahimimi me ID 1100320090S.

50. Nëpërmjet procesverbalit me nr. 511 prot., datë 19.07.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka njoftuar kandidatin në lidhje me përmbajtjen e shkresës me nr. 17537/1 prot., datë 06.07.2022 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nëpërmjet të cilës, i ka bërë me dije se: "...Në vijim të procedurës së verifikimit të kandidaturës suaj, për vendin vakant për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ju ridrejtoa Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me marrjen e një informacioni me të plotë, si në drejtim të kthimit përgjigje të kësaj drejtorie, konkretisht, Sektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me shkresën nr. 3810/1 prot., datë 24.03.2022, pas procedurës standarde të kërkimit të informacionit që KED ndjek për të gjithë kandidatet me organet tatimore, ashtu dhe në drejtim të gjetjeve nga akti i kontrollit të ILDKPI, të datës 18.05.2022, si dhe vërtetimit mbi mospasjen detyrime tatimore, të datës 08.06.2022, të lëshuar nga Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, sipas kërkesës suaj, si kandidat. Për sa më lart, po dorëzojmë shkresën e sipërcituar që ka sjellë Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë dhe nëse e vlerësoni të arsyeshme për të dhënë komente jeni i lutur për ti paraqitur ato **brenda 3 ditëve** nga marrja e kësaj shkrese, fizikisht pranë zyrës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ose nëpërmjet e-mail, nëse ata bëhen funksional (Këshilli 3)....".

51. Në datën 03.08.2022, kandidati ka paraqitur para Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vërtetimin me nr. 671 prot., datë 02.08.2022 të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, dokumenti

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

cili është administruar nëpërmjet proces-verbalit me nr. 551 prot., datë 03.08.2022 të mbajtur mes kandidatit Gent Ibrahimit si dhe punonjësit të administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

52. Po në datën 03.08.2022, kandidatit Genti Ibrahimit i është dorëzuar relacioni i hartuar për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të kandidatit Genti Ibrahimit, për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, e cila, provohet nëpërmjet proces-verbalit me nr. 550 prot., datë 03.08.2022, i cili është nënshkruar si nga ana e kandidatit, ashtu edhe nga punonjësi i administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

53. Në datën 08.08.2022, kandidati Genti Ibrahimit ka paraqitur para Këshillit të Emërimeve në Drejtësi komentet e tij në lidhje me relacionin e hartuar për kandidaturën e tij, fakt i cili provohet nëpërmjet proces-verbalit për marrje në dorëzim të akteve me nr. 560 prot., datë 08.08.2022, në të cilin ka bërë me dije se: "...Përsa më sipër, më lejoni disa komente dhe mendime (si më poshtë) të cilat shpresoj të ndihmojnë në vendimmarrjen tuaj.

(I) Verifikimi i Arsimit (paragrafet 13 - 15 të Relacionit) – Nuk kam komente
I kërkoj Këshillit lejimin e kandidimit lidhur me këtë kusht duke qenë se nuk ndodhem në ndonjërin nga situatat e parashikuara në pikat 96 - 97 të Rregullores "Për Procedurën e Verifikimit të Kandidatëve:

(II) Përvoja profesionale (paragrafet 16 - 26 të Relacionit) –
Sa i takon gjetjeve të Relacionit lidhur me këtë kusht kam komentet e mëposhtëme, si dhe një sqarim shtesë lidhur me vitet e punës në Shkollën e Magjistraturës (vërtetimi i fundit nga SHM është lëshuar vetëm në datën 2 gusht, dhe për pasojë, nuk është reflektuar në Relacion):

Vendi i punës	Vite	Muaj	Dite	Periudha
Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP)	3	2	14	19.12.2018 - 28.02.2022: Vendim i datës 19.12.2018 (Fillim mandati) dhe Vendim i datës 02.02.2022 (mbarim mandati).
Këshilli Kombëtar i Radio-Televizionit (KKRT) - sot AMA	6	2	15	Shtator 2007 - dhjetor 2013: Vërtetim nr 3965 dt. 16.12.2021.
Këshilli i Ministrave (KM)	1	8	15	1.10.1997 - 15.06.1999: Vërtetim nr 484 dt. 10.03.2022.
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë	3	6	0	Nëntor 1993 - prill 1997: Vërtetim date 15.03.2022.
Shkolla e Magjistratures (Vërtetim 1)	7	0	0	Shtator 2016 - në vazhdi m: - Vërtetim date 10.06.2022 (Pedagog i jashtëm në Programin e Trainimit Fillestar).
Shkolla e Magjistratures (Vërtetim 2)	7	0	0	671, date 02.08.2022 (Ekspert në Programin e Trainimit Vazhdues)
Parlamenti Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi	1	7	0	Janar 2015 - Korrik 2016: Certifikate date 28.07.2016.

Sqarim : 25 muaj janë 2 vite e një muaj (dhe 44 ditë janë 1 muaj e 14 ditë).

Totali: 30 vite e 2 muaj e 14 ditë

Përsa më sipër⁶ i kërkoj Këshillit lejimin e kandidimit lidhur me këtë kusht duke qenë

⁶ Ju lutem vini re se sipas Aneksit 11 të Rregullores së Brendshme të Shkolles së Magjistratures, Pedagogu i Jashtëm në Programin e Trainimit Fillestar dhe Eksperti në Programin e Trainimit Vazhdues perkulifozohen si pjesë e stafit pedagogjik të SHM. Gjithashtu theksoj se llogaritja e viteve nga ana ime është bërë duke mbajtur parasysh interpretimet / qendrimet e

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA ELARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

se nuk ndodhem ne ndonjeren nga situatat e parashikuara ne pikat 96 - 97 te Rregullores "Per Proceduren e Verifikimit te Kandidateve.....

(III) Verifikimi i funksioneve politike (paragrafët 27 - 30 të Relacionit) - Nuk kam komente.

I kerkoj Keshillit lejimin e kandidimit lidhur me kete kusht duke qene se nuk ndodhem ne ndonjeren nga situatat e parashikuara ne pikat 96 - 97 te Rregullores "Per Proceduren e Verifikimit te Kandidateve.

(IV) Verifikimi i integritetit (paragrafët 31-36.1 të Relacionit) - Nuk kam komente.

I kerkoj Keshillit lejimin e kandidimit lidhur me kete kusht duke qene se nuk ndodhem ne ndonjeren nga situatat e parashikuara ne pikat 89 - 90 te Rregullores "Per Proceduren e Verifikimit te Kandidateve

(V) Verifikimi i integritetit (paragrafët 37 - 51 të Relacionit) -

Sa i takon gjetjeve të ILDKPKI / Relacionit lidhur me këtë kusht kam komentet e mëposhtëme:

Në lidhje me pikën 1, sqaroj se pasurite ne fjalë jane perfituar si rrjedhoje e kontrates se siper marrjes me "Brilant" shpk per ndertim objekti mbi token e trasheguar nga kandidati. Per te vertetuar sa me siper kam dorezuar ne ILDKPKI: (1). Kontraten e Siper marrjes Nr. 851 Rep. Nr. 527 Kol. date 08/06/2020 dhe (2) Akt Marreveshjen per Caktimin e Pjeses nji Naty're te Pales Pronare te Truallit Nr. 1269 Rep. Nr. 92 Kol. date 17.06.2016. Kontraten e Shkembimit nr. 1811 Rep. Nr. 1 143 Kol. date 6.9.2019 e cila nuk eshte paraqitur ne momentin e deklarimit, (pasi nuk e disponoja ne atë kohe) e kam depozituar ne KED permes postes elektronike ne daten 8 qershor 2022. Shitjet e pasurive te permendura jane deklaruar rregullisht ne kuader te deklarimit per efekt kandidimi. Gjithashtu kontratat e shitjes jane depozituar nji ILDKPKI qoftu gjate kontrollit te thelluar ne fund te vitit 2021, qofte ne kuader te kontrollit per efekt te kandidimit. Mos deklarimi i shitjes se ketyre pronave ne Deklaratat Periodike Vjetore te viteve 2019 dhe 2020 shpjegohet me faktin se keto prona, deri ne fund te vitit 2019, figuronin ne emer te nenes. Pasi ajo nderroi jete ne maj te vitit 2019, keto prona kaluan ne bashkepronesi midis kandidatit, babait te kandidatit dhe motres se kandidatit. Per me teper shitjet jane bere me prokure nga babai dhe te ardhurat jane derdhur ne llogarine e tij. Ne keto kushte mosdeklarimi i shitjeve ka qene nje pasaktesi/harrese.

Në lidhje me pikën 2, sqaroj se fjala eshte per shtepine ku une banoj aktualisht. Kjo shtepi eshte deklaruar nga une qe ne deklarimin tim te pare ne vitin 2007 (ne ate kolie isha anetar i Keshillit Kombetar te Radio Televizionit). Deklarimi eshte shoqeruar gjithnje nga Kontrata e Porosise dhe (duke Jilluar qe nga viti 2009) edhe nga kontrata e shitjes. Fakti qe ne deklaratat e viteve 2007 dhe 2008 une nuk kam deklaruar ne rubriken "Detyrimet Financiare ndaj Personave Juridike dhe Fizike" shumat qe i detyrohesh shoqerise ndertuese sipas kontrates së porosise ka pasur te beje me keqkuptimin e qellimit te kesaj rubrike e cila, teksa shpjegonte se çfare jane detyrimet financiare qe duhen deklaruar, jepte si shembuj (i) kredite, (ii) huamarrjen, (iii) detyrim per studime etj. Duke mos u ndodhur ne asnjeren prej situatave te mesiperme (thjesht kisha porositur nje shtepiparateper te cilen i kisha ne llogari bankare) nuk e kam kuptuar qe duhej te deklarofa shumat qe i detyrohesh ndertuesit sipas kontrates se porosise dhe pagesat qe beheshin periodikisht sipas kalendarit te punimeve. Shtoj gjithashtu qe kjo e mete nuk eshte vene asnjehere ne dukje nga ILDKPKI ;

Në lidhje me pikën 3, sqaroj se Ajo ç'ka eshte me e rendesishme mendoj se eshte vlera e deklaruar nga une (kandidati). Theksoj se vlera reale e shitjes se apartamentit ne vitin 2002 eshte deklaruar saktesisht nga kandidati. Te ardhurat nga shitja e ketij

deritanishme te KED lidhur me natyren e funksioneve qe konsiderohen relevante per efekt te llogaritjes se vjetersise.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

apartamenti janë deklaruar si burim për blerjen e apartamentit të dytë që është ende në pronësi të kandidatit. Fakti që kontrata e shitjes tregonte një shifër të ndryshme nga shifra e përfituar nga shitja dhe e deklaruar kishte të bënte me një marrëveshje midis shitesit dhe bleresit për të veçuar vlerën e apartamentit nga vlera totale e shitjes e cila, përveç apartamentit, përfshinte edhe mobilimin dhe një vend parkimi/garazhë të përegjistruar.

Në lidhje me pikën 4, sqaroj se: Ne vijim të ketij konstatimi nga ILDKPKI, kam ndërvepruar me ILDKPKI dhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tirane dhe kam kërkuar nga kjo e fundit saktësimin e deklaratave dhe detyrimeve tatimore. Ne vijim të ketij ndërveprimit, rilogaritjes së detyrimeve tatimore dhe kryerjes së pagesave përkatëse, siç rezultoi edhe nga leterkembimi i Relatores me DRT Tirane, nuk rezultojnë detyrime të papaguara lidhur me të ardhurat bruto nga paga dhe honorare të deklaruara sipas deklaratave të dorëzuara për periudhat deri në vitin 2020.

Në lidhje me pikën 5, sqaroj se: Ju lutem vini re se struktura e pasurive të mia të paluajtshme është mjaft komplekse. Në deklaratën time të pasurisë do të gjeni 45 pasuri të paluajtshme. Të habitur që të këtu ndonjë harrësë si kjo aq më tepër që gjatë 3 muajve të fundit (Dhjetor 2021 - Mars 2022) kam kryer 4 deklarime dhe kontrole: (i) kontrolli i thelluar në fund të vitit 2021; (ii) deklarimi pas përfundimit të detyrës; (iii) deklarimi periodik për vitin 2021; (iv) deklarimi dhe kontrolli për efekt kandidimi. Tre deklaratimet e fundit kanë pasur edhe veshitëresinë shtesë të perdorimit, për herë të parë, të sistemit elektronik....”.

54. Në mbledhjen e datës 10 Gusht 2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi pasi ka marrë në shqyrtim relacionin e hartuar për kandidatin Gent Ibrahim, ka vlerësuar që t'i drejtohet edhe njëherë disa institucioneve të treta, si ILDKPI, Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe Kuvendit të Shqipërisë për të marrë informacion më të detajuar si dhe vetë kandidatit.

55. Me shkresën nr. 564 prot., datë 12.08.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i është drejtuar ILDKPI, duke i bërë me dije se:

“Nga ana juaj, me shkresën nr. 1069/3 prot., datë 12.05.2022, është dërguar Akti Përfundimtar nr. 733/25, datë 19.05.2022, me të cilin janë dhënë rezultate të kontrollit të ushtruar për kandidatin Gent Ibrahim, ku në përfundim të analizës konkludoni se: a) Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mosdeklarim të interesave private në deklaratë ndër vite; b) Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjorë lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat, që kanë shërbyer si burim i pjesshëm për krijimin e pasurive; c) Nuk ka kryer fshetje të pasurisë; d) Nuk ka kryer deklarim të rreme; e) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Për, sa më sipër, është e domosdoshme sqarimi i disa momenteve, ndaj jeni të lutur të na informoni, konkretisht:

Së pari, na vendosni në dispozicion aktet me të cilën është bërë analiza financiare e kandidatit për çdo vit, në të cilën janë pasqyruar të ardhurat, shpenzimet përkatëse dhe vendosja e pasurive ndër vite, ose cdo lloj dokumentacioni ndihmues në këtë drejtim.

Së dyti, sa janë të ardhurat e ligjshme për të cilat rezultoi se janë paguar tatime nga kandidati dhe për sa të ardhura nuk janë paguar ato, në shifra konkrete, pasi sipas raportit tuaj nuk është evidentohet qartë, referuar kontratave dhe dokumenteve që kandidati, ju ka venë në dispozicion. Jeni të lutur, të na konkretizoni nëse vetëm të ardhurat e ligjshme, pra ato për të cilat kandidati

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

ka paguar tatimet, e justifikojnë pasurinë e kandidatit, dhe si qëndron raporti i tyre me ato ardhura për të cilat nuk janë paguar tatime.

Së treti, nga ana juaj nuk rezulton se keni pasur komunikime me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, mund të na sqaroni se si keni dalë në konkluzionin se kandidati nuk ka paguar tatimet mbi të ardhurat? Për më tepër, gjeni bashkëlidhur dhe shkresën nr. 17537/1 prot., datë 06.07.2022, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Së katërti, rezulton se kandidati ka punuar me mbivendosje në dy institucione, konkretisht, gjatë periudhës 15.03.1999, deri në datën 15 Qershor 1999, ka deklaruar se ka mbajtur funksionin Drejtorit të Kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin (pranë Këshillit të Ministrave), e cila mbivendoset me periudhën 31.03.1999 deri në datën 11.10.2007, kohë në të cilën ka mbajtur detyrën Drejtorit Ekzekutiv të Fondacionit "Instituti për Studime Publike dhe Ligjore"; Gjatë periudhës 11.10.2007 deri në datën 13.12.2013 ka deklaruar se ka mbajtur funksionin e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit, periudhë e cila mbivendoset me periudhën Shtator 2007 deri 13.02.2013, kohë në të cilën ka mbajtur detyrën juristit pranë Fondacionit "Instituti për Studime Publike dhe Ligjore".

Sipas jush, fakti që kandidati ka punuar edhe pranë KKRT/AMA edhe pranë ISPL apo edhe pranë Këshillit të Ministrave, si dhe pranë ISPL, sipas legjislacionin të kohës së ushtrimit të këtyre detyrave shtetërore, a ka qenë në kushtet konfliktit të interesit, duke pasur parasysh edhe natyrën e funksionit që ka ushtruar? Gjeni bashkëlidhur ekstraktin ISPL.

Se pesti, në lidhje me gjetjen parë sipas konkluzioneve në Akt kontrollin tuaj, (Mosdeklarim shitjes së pasurisë së paluajtshme në Vlorë, konkretisht të apartamentit me sip. 114.1 m², me çmim 51.000 euro dhe apartamentit me sip 89.66 m², me çmim 45.000 euro, në deklaratën e interesave private "Periodike vjetore 2019", si dhe shitjes së njësisë me sip.41 m², me çmim 3.800.700 lekë në deklaratën interesave "Periodike vjetore 2020", pasuri të përfituara me kontratë shkëmbimi nr. 1811 rep., nr. 1143 kol., datë 06.09.2019, cila nuk është paraqitur nga kandidati), është domosdoshme të risqaroni, nëse jemi përpara pasaktësisë apo mosdeklarimit nga ana kandidatit, duke qenë se ky fundit ka deklaruar pranë KED-së se bëhet fjalë për pasaktësi....."

55.1 Me shkresën me nr. 1069/10 Prot., datë 19.08.2022, ILDKPKI ka kthyer përgjigje, duke bërë me dije se:

"...Në aktin e përfundimit të kontrollit plotë, ILDKPKI ka krahasuar dhe vlerësuar në mënyrë plotë të saktë Deklaratën Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit Gent Ibrahimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, dokumentacionin justifikues të dorëzuar nga vetë kandidati, deklaratat interesave private ndër vite, me të dhënat e kërkuara anë të korrespondencës zyrtare pranë institucioneve publike dhe private, dhe sqarimeve dhëna nga kandidati.

Në lidhje me kërkesën tuaj, ILDKPKI me anë të shkresës nr. 2288/1 prot, datë 1.7.2022 lëndë "Kthim Përgjigje" ka vendosur në dispozicion të KED, në format elektronik, të gjithë dokumentacionin administruar gjatë procesit të kontrollit të plotë të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, përfshirë kandidatin z. Gent Ibrahimit, mbi cilin është kryer analiza financiare dhe ligjore e pasqyruar në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë.

Për sa përket, çështjeve të parashtruara mbi të ardhurat e kandidatit dhe b/shortes, si dhe pagesës së detyrimeve tatimore, në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë në analizën të ardhurave, është theksuar:

"Të ardhura të kandidatit dhe b/shortes nga paga, honorarë, konsulenca etj.. për periudhën 2000-2022, rezultojnë në total 60.089.811 lekë +434.406 Euro + 169.477 Usd, konvertuar rreth

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

132.300.000 lekë. "Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e kandidatit nga honoraret, konsulentat dhe nga punësimi në organizatat e huaja".

Si dhe në përmbledhje të të dhënave në pjesën përfundimtare ka rezultuar se: ✓Në Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, pasuria totale deri në 18.3.2022, është deklaruar bruto/neto rreth 66.950.000 lekë

✓Të ardhurat e kandidatit dhe b/shortes nga paga, honorarë, konsulenca etj., për periudhën 2000-2022, rezultojnë në total 60.089.811 lekë + 434.406 Euro + 169.477 Usd, e konvertuar rreth 132.300.000 lekë.

Të ardhurat nga paga e Tedi Ibrahimit, djali i kandidatit, rezultojnë në shumën konvertuar rreth 1.952.000 lekë.

Gjithashtu, si burim, janë deklaruar:

Te ardhurat nga shitja pasurive të paluajtshme nga ana e prindërve të kandidatit, për periudhën 1996 - 2020, janë në shumën 182.224.458 leke + 160.400 euro, konvertuar në total rreth 202.000.000 lekë. Te ardhurat nga qiradhënia pasurive të paluajtshme, për periudhën 2015-2022, konfirmohen në shumën rreth 22.725.000 lekë.

✓ Për periudhën 2000 - janar 2022, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar rreth 15.000.000 lekë.

Shpenzimet e arsimimit të djalit, Tedi, konfirmohen në shumën 26.600 euro dhe 17.485 GBP, konvertuar në shumën rreth 5.822.000 lekë.

Për sa më sipër, ILDKPKI sqaron se nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se kandidati dhe b/shortja kanë zotëruar llogari bankare të përbashkët, ku janë kredituar të ardhurat e krijuara nga punësimi i tyre ndër vite, në vlerën 132.300.000 lekë. Në këto llogari janë kredituar, si të ardhurat për të cilat kandidati ka paraqitur dokumentacioni mbi pagesën e detyrimeve tatimore, ashtu edhe të ardhura për të cilat nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore.

Nga analiza e dokumentacionit justifikues të paraqitur nga kandidati për punësimin e tij gjatë periudhës 2003-2017, konkretisht marrëveshje e kontrata shërbimi me agjenci kryesisht ndërkombëtare, rezulton se natyra e tyre është e ndryshme në lidhje me përcaktimin e palës përgjegjëse për kryerjen e pagesës së detyrimeve tatimore. Konkretisht, janë paraqitur marrëveshje (kontrata) në të cilat është e përcaktuar se pagesa e detyrimeve tatimore i përket punëmarrësit dhe marrëveshje (kontrata) në të cilat nuk është e përcaktuar pala përkatëse për këto detyrime. Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur për llogaritjet një shumë rreth 39.000.000 lekë, të ardhura të kandidatit, e përfshirë në shumën 132.300.000 lekë, për të cilën nuk ka dokumentacion për të vërtetuar pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara.

Me shumën e krijuar, kandidati dhe b/shortja, në vite, kanë kryer shpenzime apo pagesa në funksion të krijimit të pasurisë së tyre. Në këto kushte, duke qenë se në llogaritjet e tyre janë kredituar, si të ardhurat për të cilat është provuar pagesa e detyrimeve tatimore, ashtu edhe të ardhurat për të cilat nuk është provuar pagesa e tyre, duke krijuar me to një shumë të vetme, është objektivisht e pamundur për të përcaktuar shumën, se cila nga këto dy lloje të ardhurash, ka shërbyer për krijimin e një pasurie të caktuar. Në këto kushte është arritur në konkluzionin, në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë në pjesën mbi të ardhurat se: "b) Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat, që kanë shërbyer si burim i pjesshëm për krijimin e pasurive"

Me qëllim saktësimin e të dhënave për pagesën e detyrimeve tatimore, siç rezulton nga të dhënat e paraqitura në dokumentacionin e administruar, është kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe ISSH.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Për më tepër, kandidati i është kërkuar që të paraqesë dokumentacion justifikues në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore, për të cilat nuk është paraqitur deri në përfundimin e procedurës administrative dhe hartimit të aktit të përfundimit të kontrollit të plotë.

Në analizim të shkresës së ardhur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë me nr. 1753/1, prot date 6.7.2022, drejtuar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konstatohet se të dhënat e paraqitura janë të njëjta me të dhënat e administruara nga ISSH, si të dhëna që gjenerohen në mënyrë elektronike nga sistemi. Në lidhje me detyrimet tatimore, vetë shkresa konfirmon se kandidati ka marrë masa për të dorëzuar DIVA për vitin 2017, me datë 2.6.2022, pas dorëzimit të aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të kryer për deklaratën e interesave private të kandidatit.

Nga të dhënat e administruara pranë ILDKPKJ, kandidati duhet të plotësonte dhe dorëzonte DIVA, në ose për të gjitha vitet që ka kaluar shumën e të ardhurave bruto mbi 2,000,000 lekë/vit, ku referuar dokumentacionit të paraqitur, ky prag është kaluar në disa periudha tatimore përpara vitit 2017.

Për sa i përket, çështjes së konfliktit të interesave në lidhje me periudhën gjatë të cilës kandidati z. Gent Ibrahim ka ushtruar funksionin e anëtarit të ish-KKRT, si dhe jurist pranë ISPL (2007-2013), rezulton se:

Ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, aktualisht i shfuqizuar, ka pasur të parashikuar sa më poshtë vijon:

Neni 8 "Përbërja": "Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë të zgjedhur nga radhët e personaliteteve në fushat e politologjisë, drejtësisë, masmedias, sociologjisë apo shkencave të tjera humanitare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëllimet e veprimtarisë radiotelevizive, siç përcaktohet në nenet 35 e 36 të këtij ligji. KKRT-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me këtë ligj nën mbikëqyrjen e Kuvendit. Funksioni i Kryetarit dhe i Zëvendëskryetarit është me kohë të plotë dhe i papajtueshëm me çdo detyrë ose funksion tjetër publik e privat, me përjashtim të mësimdhënies. Paga e Kryetarit, e Zëvendëskryetarit dhe masa e shpërblimit të 5 anëtarëve të tjerë të këtij këshilli caktohet në përputhje me ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të pavarura të krijuara me ligj".

Neni 14 "Papajtueshmëritë": "Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit nuk lejohen: 1. Të jenë anëtarë të partive dhe shoqatave politike, si dhe të kenë ushtruar detyrën e kryetarit të Bashkisë, deputetit, anëtarit të Këshillit të Ministrave apo të prefektit gjatë legjislaturave të fundit ose të kenë konkurruar për kryetar Bashkie apo në zgjedhjet e organizuara për to; 2. Të jenë aksionarë, anëtarë të organeve drejtuese, të punësuar të shoqërive anonime, që kanë lidhje me mjetet e informimit masiv ose të përfaqësojnë interesa tregtarë që janë në kundërshtim me funksionin e tyre; 3. Të lidhen me interesa financiarë që kanë të bëjnë me transmetimet në radio dhe televizion nëpërmjet pronësisë, marrëdhënieve të punësimit ose tregtare; 4. Të mbrojnë interesat e një shoqërie apo firme prodhimesh audiovizuale, botimesh shtypi, reklame ose telekomunikacioni. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së detyrës, anëtarët e KKRT-së nuk lejohet të shprehin a të mbajnë qëndrime publike që cenojnë paanshmërinë e tyre në raport me interesat e përfaqësuar në pikat 1 deri 4 të këtij neni. Detyrimet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni do të vazhdojnë të jenë në fuqi për një vit pas mbarimit të mandatit të anëtarëve të KKRT-së. Punonjësit e administratës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit nuk lejohet të jenë anëtarë të bordeve administruese të rrjeteve transmetuese publike e private, nuk lejohet të jenë të licencuar për transmetime radiotelevizive, nuk lejohet të mbrojnë interesat e një subjekti që ka marrë licence radiotelevizive apo të ushtrojnë funksione në shërbim të tij".

Ligji nr. 8410/1998, i ndryshuar, rezulton të ketë pasur parashikime mbi mënyrën e ushtrimit të funksionit të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit, duke përcaktuar ushtrimin e funksionit me kohë të plotë, si dhe të papajtueshmërisë me çdo detyrë ose funksion tjetër publik e privat, me përjashtim

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike: info@ked.gov.al Numra telefonikë: +355 4 2257302

të mësimdhënies. Në lidhje me anëtarët e ish KKRT ushtrimi i funksionit, si dhe rastet e papajtueshmërisë, kanë qenë të ndryshëm nga Kryetari dhe Zëvendëskryetari.

Në lidhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, në nenin 4. ka përcaktuar rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar nga: "a) çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për: i) akte dhe kontrata administrative; ii) akte të organeve gjyqësore, noteriale, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga organet e përmbarimit dhe akte të organeve të prokurorisë; iii) akte normative, si dhe vetëm ato ligje që krijojnë pasoja juridike për subjekte individualisht të përcaktuara; b) çdo zyrtar i institucioneve shtetërore, qendrore ose vendore dhe çdo punonjës i subjekteve të përcaktuara në shkronjën "d" ose përfaqësues i subjekteve të përcaktuara në shkronjën "ç", në subjektet e përmendura në shkronjën "d", kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata, që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile, me palë këto subjekte; c) çdo zyrtar ose punonjës, që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, në njërin nga subjektet e shkronjës "ç" ose "d" të pikës 1, të këtij neni; ç) çdo institucion shtetëror, qendror ose vendor; d) çdo organ apo subjekt i krijuar dhe/ose në varësi të subjekteve të shkronjës "ç", përfshirë edhe ndërmarrjet shtetërore ose vendore, shoqëritë tregtare me pjesëmarrje kontrolluese të kapitalit shtetëror ose vendor, organizatat jofitimprurëse dhe persona të tjerë juridikë, të kontrolluar nga subjektet e shkronjës "ç" ose nga vetë subjektet e kësaj shkronje; dh) personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në këtë ligj".

Për anëtarët e organeve të autoriteteve rregullatore, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, neni 30 "Kufizimet për anëtarin e organit të autoritetit rregullator" parashikon se: "Për anëtarin e organit të një autoriteti rregullator ose të mbrojtjes së konkurrencës, përfshirë Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Zëvendësguvernatorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj: a) zbatohen të gjitha kufizimet dhe lejitimet e përcaktuara në nenin 31 të këtij ligj; b) zbatohet edhe kushti që një zyrtar i tillë nuk mund të zotërojë asnjë drejtë, tërthortë, sipas kuptimit të neni.

Në referim 9367/2005, "Zyrtari nivelit të lartë të shërbimit të lartë mesëm Armatosura, sipas përgjithshme titullarë rregullator sipas neni 30 këtij apo institucioneve publike nuk janë pjesë ose në organizatë jofitimprurëse, në që përputhet pritet juridiksionit të kompetencës për zyrtari përcaktues nxjerrjen këtyre akteve, mbi këto shoqëri organizata apo shoqëri që bashkëpunojnë fjalë, përjashtuar kur pozicion shoqëri vjen funksionit c) nuk mund ushtrorjnë që të ardhura në formën personit përfaqësuesit shkronjën neni, dhe nuk mund punësuar, të mund në mënyrë ose përjashtim rastit shoqëria veprimtari përputhet juridiksionit zyrtarit kompetencës vepruar, akte të nxjerra nga zyrtari thelbësor përcaktues akteve, cilat përfitime bashkëpunojnë fjalë, rast cilin zyrtari mund zotërojë aksione ose kapital vetëm, përputhje kushtet përcaktuara në shkronjën 27 ligji....".

Në analizë të sa më jeni ILDKPKI krijuar institucion në vitin 2003 kuadër të miratimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 kontrollin pasurive, ndryshuar, dhe ka marrë kompetenca me parandalimin konfliktit të interesave, vitin 2005 pas miratimit të ligjit konfliktit ushtrimin i cili ka hyrë në fuqi 2005. Në këtë kuadër, gjithë periudhat parashtruara përpara hyrjes në ligj, periudhat për vitin 1997-1999, janë veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë.

Për sa i përket, periudhës gjatë të cilës kandidati ka ushtruar funksionin e anëtarit të ish KKRT, si dhe jurist pranë ISPL (2007-2013), ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka pasur të parashikuar rastet e papajtueshmërisë të Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Në referim të parashikimeve të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, të dhënat e përcjella me anë të shkresës tuaj nr. 564 prot, datë 8.2022, të dërguar nga ISPL për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, nuk përmban informacion shterues e të qartë me qëllim përjashtimin e rasteve të mundshme të konfliktit rast për rast të interesave se të gjitha projektet apo konceptimet e projekteve, në të cilat

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

është përfshirë kandidati, nuk kanë pasur fushë ndërlidhje apo ndërveprimi me veprimtarinë e ish-KKRT.

Në lidhje me çështjet e fundit, ILDKPKI ka parashtruar qëndrimin në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë, dërguar pranë KED, i cili si organ përgjegjës vendimmarrës ka në kompetencë vlerësimin e mëtejshëm të qëndrimeve të kandidatit... ”.

56. Me shkresën nr. 565 prot., datë 12.08.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, duke i bërë me dije se:

“...Në procedurën e verifikimit të plotësimin të kushteve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të nenit 228 pika 5 dhe të nenit 229 pika 4 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kërkon informacione dhe dokumentacione nga institucione të tjera.

Në këtë kuadër, ju drejtohem me këtë kërkesë për marrje informacioni dhe vendosjen në dispozicion të dokumentacioni që institucioni juaj disponon për kandidatin Genti Nesip Ibrahimimi i dtl. 20.03.1970, me nr personal H00320090S, konkretisht si më poshtë:

Me shkresën nr. 17537/1, prot., date 01.07.2022, nga ana juaj na bëhet me dije se për kandidatin nuk janë pasqyruar të ardhura nga paga/shpërblimet si anëtar i KKRT apo edhe pranë Shkollës së Magjistraturës për të gjitha periudhat. Lutemi, mund të na sqaroni arsyen e mospasqyrimin të këtyre të ardhurave? (bashkëlidhur shkresa nr. 17537/1, prot., datë 01.07.2022)... ”.

56.1 Me shkresën nr. 22668/1 prot., datë 09.09.2022, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, i ka kthyer përgjigje Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në lidhje me çështjet e adresuara, duke i bërë me dije se:

“Në përgjigje të shkresës suaj nr. 565 prot., data 12/08/2022 me Lënda: Kërkesë për informacion dhe dokumentacion, protokolluar me tonën nr. 22668 prot., data 12.08.2022, Ju informojmë referuar regjistrimeve në sistemin informatik të tatimeve dhe të dhënave që disponojmë deri në datën e sotme si më poshtë:

Përsa ju kërkon sqarim lidhur me pasqyrimin e të ardhurave nga paga /shpërblime si anëtar i KKRT apo Shkolla e Magjistraturës nga Z. Genti Nesip Ibrahimimi me ID H00320090S, ju informojmë se, nga listëpagesat e dorëzuara elektronikisht nga subjektet punëdhënës nga periudha dhjetor 2011 dhe në vijim nuk rezultojnë të dhëna për të ardhura nga paga dhe shpërblime të përfituara nga Genti Ibrahimimi me ID H00320090S nga subjekti KKRT. Ndërsa, përsa i përket të ardhurave bruto nga paga të rezultuara nga listëpagesat e subjektit "Shkolla Magjistraturës" periudha 2012 deri 2021 rezulton se janë përfshirë në vlerën totale të deklaruar për të ardhurat bruto nga paga dhe shpërblime në rubrikën [3] të deklaratave individuale vjetore të dorëzuara nga ky individ deri në datën e sotme. Sqarojmë se të dhënat që disponojmë sipas listëpagesave të deklaruara elektronikisht në sistemin informatik tatimor e@ts, fillojnë nga muaji dhjetor 2011, ndërsa listëpagesat përpara periudhës tatimore dhjetor 2011, administrohen nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore ”.

57. Me shkresën nr. 566 prot., datë 12.08.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, duke i bërë me dije se:

“...Në procedurën e verifikimit të plotësimin të kushteve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të nenit 228 pika 5 dhe të nenit 229 pika 4 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kërkon informacione dhe dokumentacione nga institucione të tjera.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA ELARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

Në këtë kuadër, ju drejtohem me këtë kërkesë për marrje informacioni dhe vendosjen në dispozicion të dokumentacionit, që institucioni juaj disponon për kandidatin Genti Nesip Ibrahimimi i dtl. 20.03.1970, me nr personal H00320090S, konkretisht si më poshtë:
1- Aktet dhe dokumentacioni që iu keni administruar nga institucione të tjera apo aktet që iu keni prodhuar gjatë procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të këtij kandidati për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për plotësimin e kushtit të përvojës profesionale prej 15 vjetësh dhe mbi verifikimin e pasurisë....”.

57.1 Me shkresën nr. 2774/1 prot., datë 29.08.2022. Kuvendi i Shqipërisë, i ka kthyer përgjigje Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në lidhje me çështjet e adresuara, duke i bërë me dije se:

“Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 12.08.2022 lidhur me marrjen e informacionit dhe vendosjen në dispozicion të dokumentacionit që institucioni i Kuvendit ka administruar nga institucione të tjera apo akte që janë prodhuar gjatë procedurës së verifikimit dhe vlerësimit për kandidatin Gent Ibrahimimi për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, lutemi gjeni një kopje të dokumentacionit të mëposhtëm:

1. Vendim i Kuvendit nr. 4/2018 "Për rrëzimin e listës në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Miratuar më 25.1.2018 - Raport dhe procesverbale nga Nënkomisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë

- Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për procesin e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore dhe kriterëve profesionale e morale për kandidatët për Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve - Njoftim i Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me listën dhe raportin për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve.

2. Vendim i Kuvendit nr. 12/2018 "Për rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Miratuar më 1.2.2018 - Njoftim, raport dhe procesverbal nga Nënkomisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Vendim i Kuvendit nr. 19/2018 "Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Miratuar më 8.2.2018 -Njoftim, raport dhe procesverbal nga Nënkomisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

4. Njoftime, informacione të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kryetares së Bordit Drejtues të ONM-së lidhur me verifikimin e kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve.

5. Njoftim i Shkollës së Magjistraturës për përcjelljen e dokumentacionit për kandidatin Gent Ibrahimimi për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve.

6. Kërkesë për verifikim e Sekretarit të Përgjithshëm, njoftim i Autoritetit për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore dhe të integritetit profesional e moral për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve.

7. Kërkesë për verifikim e Sekretarit të Përgjithshëm, njoftim, vendim i Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore dhe të integritetit profesional e moral për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve.

8. Kërkesë për verifikim e Sekretarit të Përgjithshëm, informacion i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore dhe të integritetit profesional e moral për kandidatët për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve.

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

9. Formularët e vlerësimit nga trupa e pedagogëve për kandidaturën e Gent Ibrahimit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas pikëzimit të dhënë nga çdo anëtar i Mbledhjes së Posaçme të drejtuesve të institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Shkollës së Magjistraturës...".

58. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nëpërmjet procesverbalit me nr. 572 prot., datë 29.08.2022 i ka komunikuar kandidatit Gent Ibrahimit kthimin e përgjigjes me nr. 1069/10 prot., datë 19.08.2022 të dhënë nga ILDKPI, me qëllim njohjen me këtë akt.

59. Po kështu kandidatit iu bënë disa pyetje shtesë nga e ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për sa vijon: (i) për vilat C7 dhe C8, për të cilat ILDKPKI ka deklaruar se referuar kontratave të shitblerjes, kanë të njëjtat sipërfaqe, janë nënshkruar në të njëjtën ditë, por kanë vlera të ndryshme. A mund të sqaroni, përse kjo diferencë? (Faqja nr.25 e Akt-kontrollit); (ii) sipas Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, rezulton se: "Ndërsa për tatimet e deklaruara të paguara gjatë vitit lidhur me të ardhurat e deklaruara nga qiraja sipas "Deklaratave Individuale Vjetore të të Ardhurave" të dorëzuara nga ky individ për vitet 2019 dhe 2020, me shkresën tonë nr. 14154/1 prot., me lëndë "Kthim përgjigje dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni", drejtuar Z. Genti Ibrahimit me ID H00320090S i është kërkuar dokumentacioni vërtetues sipas përcaktimit të UMF nr. 5, data 30.01.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, pika 2.8.6.1 gërmat d).. Kopje të kontratave të qirasë për të ardhurat lidhur nga qiraja të deklaruara dhe dokumentin që vërteton pagesën e tatimit të deklaruar të paguar gjatë vitit lidhur me këto të ardhura, por deri në datën e sotme nuk është paraqitur ky dokumentacion". Pra, ju është kërkuar plotësimi i dokumentacionit në lidhje me kontratat e qerases, me të cilat ju keni gjeneruar të ardhura dhe dokumentacioni përkatës që vërteton pagimin e tatimit. A mund të sqaroni në lidhje me fazën ku ndodhet ky proces? (iii) referuar të ardhurave tuaja, a mund të sqaroni sa keni deklaruar për çdo vit si subjekt deklarues pranë ILDKPKI, që nga viti 2007, dhe sa keni deklaruar si subjekt tatimpagues pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë, (DIVA)? (iv) në lidhje me mobilimin e apartamentit të Komuna e Parisit, mund të shpjegoni vlerën e ulët të shitjes së kësaj pasurie në vlerën 3.000.000 lekë, ndërkohë që ju e keni blerë në vlerën 3.600.000 lekë. A mund të depozitoni një deklaratë noteriale nga blerësi në lidhje me diferencën që krijohet nga shitja e garazhdit dhe mobilimit? Po ashtu, mund të na sqaroni më hollësisht lidhur me prapësimin tuaj, se garazhdi/parkimi ka qenë i paregjistruar. Nëse është e mundur na vini në dispozicion kontratën e shitjes të vitit 2002.

59.1. Në datën 02.09.2022, kandidati ka depozituar para Këshillit të Emërimeve në Drejtësi shpjegime për pyetjet si dhe dokumentacionin mbështetës, në të cilin ka pasqyruar se: "...Sqaroj se unë jam palë porositës (sipas kontratës së sipërmarrjes) dhe palë blerëse (sipas kontratës së shitjes) vetëm për vilën C7. Çmimi i blerjes së vilës C7 është 237.300 Euro (Shih Aneks 1 për kopje të këtyre kontratave. Kopjet e vërtetuara sipas ligjit janë depozituar në ILDKPKI). Vila C7 është në bashkëpronësi (50%) me bashkëshorten. Vila C8 është porositur dhe blerë nga nëna dhe babai (shih Aneks 2 për kopje të këtyre kontratave. Kopjet e vërtetuara sipas ligjit janë depozituar në ILDKPKI). Sot unë jam pronar i vilës C8 në masën 1/6, si rezultat i trashëgimisë pas vdekjes së nënës. Në këto kushte nuk mund të jap sqarime të mëtejshme për diferencën në çmim, pasi nuk jam unë blerësi i vilës C8. ...Sqaroj se kontratat e qirasë të cilat i kam deklaruar si të ardhura janë depozituar në ILDKPKI në kuadër të kontrollit të thelluar për shkak të funksionit në fund të vitit 2021 dhe në kuadër të kontrollit të fundit për efekt të kandidimit. Të gjitha këto kontrata specifikojnë qartë (në nenin 5, paragrafi 2) si më poshtë: "Mbi këtë shumë, qiramarrësi do të mbajë në burimi tatimin prej 15% (jepet shifra përkatëse) dhe do ta derdhë atë për llogari të autoritetit tatimor". Për lehtësi të vlerësimit nga KED po bashkëngjis si Aneks 3 kopje të kontratave (kopjet e vërtetuara sipas ligjit janë dorëzuar në ILDKPKI). ...Sa i takon pyetjes së parë (sa keni deklaruar për çdo vit si subjekt deklarues pranë ILDKPKI që nga viti 2007), sqaroj se nuk kam ndonjë kundërshtim apo saktësim lidhur me shifrat që ka evidentuar ILDKPKI në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë. ...Sa i takon pyetjes së dytë (sa keni deklaruar si subjekt tatimpagues pranë DRV Tiranë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

sipas ligjit nr. 10343/2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1991 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar), sqaroj se duke filluar nga viti 2012 (kur ka filluar zbatimi i ligjit në fjalë), kur më ka lindur detyrimi si subjekt tatimpagues me deklarim, për kontratat të cilat specifikojnë se detyrimi për pagesën e detyrimit tatimor është i konsulentit, kam deklaruar pranë DRT të ardhura në masën 8.511.700 lekë dhe kam paguar detyrimin përkatës tatimor në masën 1.015.570 lekë. Për më shumë detaje shih Aneks 4....Sqaroj se në asnjë rast unë nuk kam deklaruar vlerën e shitjes së apartamentit në rrugën Komuna e Parisit në masën 3.000.000 lekë. Unë kam deklaruar gjithnjë shifrën 50.000 USD si vlerë e shitjes së apartamentit në fjalë (këtë e vërteton edhe hyrja në llogarinë bankare nga blerësi). Siç kam shpjeguar në një komunikimin me të hershëm me KED, përpara mbledhjes së datës 10 gusht, fakti që kontrata e shitjes (shih Aneks 5) tregonte një shifër të ndryshme nga shifra e përfituar nga shitja, kishte të bënte me një marrëveshje midis shitësit dhe blerësit për të veçuar vlerën e apartamentit nga vlera totale e shitjes e cila, përveç apartamentit, përfshinte edhe mobilimin dhe një vend parkimi/garazhd të pajisur. Mbi vendin e parkimit që rezervohet për apartamentin është ndërtuar nga ndërtuesi një garazhd i cili nuk ka qenë i regjistruar si pronë me vehte. Kontrata e shitjes dhe një hartë janë bashkëngjitur (shih aneks 5). Përkundrejt verifikimeve të kryera në harkun kohor 29 gusht -1 shtator 2022, më rezultoi se blerësi nuk e disponon më apartamentin e blerë prej meje në vitin 2002 (e ka shitur tek një palë e tretë). Në këto kushte e kam të pamundur të siguroj një deklaratë noteriale nga blerësi në lidhje me diferencën që krijohet nga shitja e garazhdit dhe mobilimit. Sidoqoftë marrëveshja mes nesh nuk ka pse të vilet në dyshim, përse kohë palët kanë lirmosur lirisht kontratën, pala blerëse ka kryer pagesën e dakordësuar dhe unë kam deklaruar saktë vlerën e përfituar nga shitja".

60. Në seancën e datës 08.09.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi mori në shqyrtim çështjen që ka lidhje me kandidaturën e z. Gent Ibrahimit, vlerësoi që të vijojë procedurën e verifikimit të kandidaturës së tij, duke vendosur për të thirrur një ekspert kontabël të licencuar me qëllim dhënien e përgjigjeve rreth disa çështjeve që kanë të bëjnë me kriterin e verifikimit të pasurisë. Si ekspert kontabël për të kryer aktin e ekspertimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka caktuar ekspertin Valbona Kraja.

61. Nëpërmjet formës elektronike, në datën 08.09.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka bërë me dije kandidatit Genti Ibrahimit se: "...Në datën 08.09.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi mori në shqyrtim çështjen që ka lidhje me kandidaturën tuaj, vlerësoi që të vijojë procedurën e verifikimit të kandidaturës suaj, duke vendosur për të thirrur një ekspert kontabël të licencuar me qëllim dhënien e përgjigjeve rreth disa çështjeve që kanë të bëjnë me kriterin e verifikimit të pasurisë. Bazuar në përcaktimet e pikës 72, të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: "Kandidati që verifikohet njoftohet menjëherë për ekspertin e caktuar nga Këshilli. Jo më vonë se 5 ditë nga ardhja djehi, kandidati njofton Këshillin, duke parashtruar me shkrim edhe motivet konkrete përkatëse, nëse pretendon gjendjen e papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit me ekspertin. Lidhur me pretendimet e kandidatit, Këshilli disponon sipas ligjit", Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ju informon se në cilësinë e ekspertit kontabël për të dhënë sqarime rreth çështjeve që kanë të bëjnë me verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaturën tuaj, ka caktuar si ekspert kontabël të licencuar, znj. Valbona Kraja. Bazuar sa më sipër, në respektim të afatit ligjor 5 ditor, jeni i lutur që ti bëni me dije Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nëse ekziston ndonjë shkak ligjor që krijon gjendjen e konfliktit të interesit apo gjendjen e papajtueshmërisë të ekspertit kontabël të licencuar të caktuar nga Këshilli për kryerjen e aktit të ekspertimit për verifikimin e kandidaturës suaj në kriterin e pasurisë. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ju informon se

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

mbledhja e radhës për ti dhënë detyrat ekspertit sipas përcaktimeve të pikës 73 të Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019, i ndryshuar, është caktuar të zhvillohet në datën 16.09.2022, ora 12.00...".

62. Po në formë elektronike, në datën 13.09.2022, kandidati Gent Ibrahimimi ka bërë me dije Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se: *"...Në dijeninë time nuk ka ndonjë shkak/situatë që të përcaktojë gjendjen e konfliktit të interesit apo papajtueshmërisë në lidhje me znj. Valbona Kraja...".*

63. Me vendimin e ndërmjetëm me nr. 39, datë 16.09.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka caktuar ekspertës kontabël Valbona Kraja këto detyra: *"...Eksperti i caktuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, të ketë akses në dokumentacionin e depozituar, administruar pranë ILDKPI ndër vite për qëllime të kryerjes së ekspertizës (deklaratat vjetore të pasurisë së kandidatit për vitet 2007-2021 etj), apo edhe institucioneve të tjera sipas vlerësimit. Ekspertit i caktohen këto detyra:*

a) Per secilin vit, të evidentohen në analizë financiare të ardhurat e kandidatit dhe personave të lidhur, për sa nga të ardhurat janë paguar tatimet, për sa nga të ardhurat nuk janë paguar tatimet, shpenzimet, balancat, me qëllim që të konkludohet nëse për pasuritë e palauajtshme dhe të luajtshme të vëna sipas viteve të deklaruara (Garden Vila C7 Lumlërë; automjeti me targë AB526BC dhe automjeti me targë AB647DH; kursime bankare të cituara në formularin e pasurisë së kandidimit), justifikohen vetëm me të ardhurat për të cilat janë paguar tatimet dhe për të cilat ekziston dokumentacion justifikues;

b) Për secilin vit, të evidentohet si zë i veçantë e ardhura për të cilin mungon dokumentacioni për pagimin e tatimit dhe cili e ka pasur detyrimin për pagimin e tatimeve;

c) Të evidentohen të ardhurat, për të cilat kandidati ka paguar më vonë tatimet si dhe të përcaktohet për zërin "të ardhura për të cilat mungon dokumentacioni për pagimin e tatimit", "shuma përkatëse e tatimit";

d) Sa rezulton në total shuma e të ardhurave të deklaruara nga kandidati dhe bashkëshortja, për të cilën nuk janë paguar tatimet? Cilave kontrata dhe cilave pagesa i përket shuma përkatëse.

Kopje e këtij vendimi do ti njoftohet edhe kandidatit Genti Ibrahimimi. Përgatija e aktit të ekspertimit të dorëzohet nga ekspertja brenda datës 07.10.2022".

64. Nëpërmjet rrugës elektronike, në datën 20.09.2022 i ka komunikuar kandidatit vendimin e ndërmjetëm nr. 39, datë 16.09.2022 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

65. Në datën 07.10.2022, ekspertja kontabël Valbona Kraja ka paraqitur para Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aktin e ekspertimit kontabël, i cili është administruar me nr. 598 prot., datë 07.10.2022. Po në këtë datë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në rrugë elektronike i ka komunikuar kandidatit aktin e ekspertimit kontabël të dorëzuar nga ekspertja Valbona Kraja.

66. Me e-mailin e datës 10.10.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka komunikuar kandidatit aktin e ekspertimit kontabël si dhe i ka bërë me dije se: *"... Ju bëjmë me dije se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi do të zhvillojë mbledhjen e radhës në datën 14.10.2022, ora 12:00. Në këtë mbledhje është përcaktuar në rend dite që të merret në shqyrtim edhe kandidatura tuaj, duke vlerësuar aktin e ekspertimit kontabël që ekspertja Valbona Kraja ka paraqitur pranë Këshillit në datën 07.10.2022. Në rast se keni komente apo prapësime për të paraqitur para Këshillit në lidhje me aktin e ekspertimit kontabël, i cili ju është komunikuar me e-mail ditën e premte, datë 07.10.2022, jeni i lutur që të paraqisni opinionin tuaj, përpara se Këshilli të marrë në shqyrtim këtë çështje".*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

67. Nëpërmjet formës elektronike të komunikimit, kandidati Genti Ibrahimimi në datën 11.10.2022 i ka bërë me dije Këshillit të Emërimeve në Drejtësi se: *"...Pasi u njoha me aktin e ekspertimit të përgatitur nga ekspertja kontabël, Ju bëj me dije se nuk kam komente apo prapësime lidhur me gjetjet e aktit të ekspertimit..."*.

68. Sa më sipër, akti i ekspertimit kontabël i paraqitur nga ekspertja Valbona Kraja, që do të nënshtrohet vlerësimit të Këshillit gjatë procedurës për verifikimin e kandidimit të kandidatit Genti Ibrahimimi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 13.01.2022, ju është njoftuar të gjithë anëtarëve të Këshillit.

III. Njoftimet dhe thirrja e Mbledhjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

69. Pas komunikimit me kryetarin e KED-së dhe caktimit të mbledhjes, kandidati Genti Ibrahimimi i është njoftuar në rrugë elektronike koha e zhvillimit të mbledhjes, duke i dërguar edhe kopje të akteve. Njoftimi i tij kryhet në zbatim të pikës 34 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, duke administruar një kopje të njoftimit në dosjen e kandidatit.

70. I njëjti njoftim, bashkë me aktin e ekspertimit i dërgohet edhe Avokatit të Popullit. Kopje e këtij njoftimi administrohet gjithashtu në dosjen e kandidatit.

71. Koha e zhvillimit të mbledhjes, rendi i ditës relacioni dhe akti i ekspertimit për kandidatin Genti Ibrahimimi i njoftohen edhe subjekteve, të cilët sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e KED-së. Edhe kopjet e këtyre njoftimeve administrohen në dosjen e kandidatit. Gjithashtu, dita dhe ora e zhvillimit të mbledhjes së KED-së, si dhe rendi i ditës publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

72. Në mbledhjen e datës 10.08.2022, u relatua relacioni, u diskutua mes anëtarëve, si dhe u dëgjua Avokati i Popullit, i cili në thelb parashitroi se: *"...Përsa i përket verifikimit të procedurave, në pikën 25 të relacionit thuhet që në datën 25.07 kandidati ka sjellë argumentat në lidhje me plotësimin e kriterëve të viteve të punës, ku del 21 vjet, 25 muaj e 44 ditë. Ndërkohë siç doli dhe nga diskutimet e gjata që u bënë nga disa prej anëtarëve, në datën 8 gusht kandidati ka sjellë një dokument tjetër ku thotë që ka 30 vite, 2 muaj e 14 ditë, ose më saktë jep shpjegime dhe thotë që pasi më ka ardhur relacioni kam marrë disa dokumenta të tjera dhe ka saktësuar periudhën. Nisur nga metodologjia për vlerësimin dhe çertifikimin, duke qënë se diferenca është mes 21 viteve dhe 30 viteve lëviz me 2 pikë, do ju rekomandonim që të thellohej hetimi tek kjo pjesë, pra ai ka sjellë dhe dokumenta shoqëruese siç edhe ju e diskutuat për të mos e zgjatur."* Në mbledhjen e datës 14.10.2022, u diskutua mes anëtarëve mbi aktin e ekspertimit, si dhe u dëgjua Avokati i Popullit, i cili parashitroi se: *"Nuk ka pasur kohë për shqyrtimin e aktit të ekspertimit, pasi është marrë me shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatit tjetër që ishte në rend dite"*.

IV. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

73. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se:

"4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës."

Kësbilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

74. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

75. Bazuar në të dhënat zyrtare të konfirmuara nga institucionet perkatëse, (shih prg.18-25), Këshilli konstaton se kandidati ka ushtruar funksionin e pedagogut efektiv pranë Fakultetit të Drejtësisë për 3 vjet e 6 muaj. Po kështu, kandidati ka qenë këshilltar ligjor në Kabinetin e Ministrisë të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin pranë Këshillit të Ministrave, 1 vit, 4 muaj e 15 ditë; Drejtor i Kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Reformën Legjislative dhe Marrëdhëniet me Kuvendin pranë Këshillit të Ministrave 3 muaj, detyra të mbajtura para 10 viteve nga data e kandidimit. Kandidati ka qene anëtar i Këshillit Kombëtar të Radio Televizionit (sot, Autoriteti i Mediave Audiovizive) gjithsej 6 vjet e tre muaj; pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës, deri në marrjen e detyrës së anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, (shih prg.23), si dhe anëtar dhe njëkohësisht Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjithsej 3 (tre) vjet, 1 (një) muaj dhe 14 ditë, duke marrë në konsideratë datën e kandidimit.

76. Për shkak të specifikës që ka funksioni i mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli vlerëson të domosdoshme të theksojë se qenia pedagog i kësaj Shkolle përfshihet, së paku, brenda konceptit të “lektorit të së drejtës”, sipas parashikimit të nenit 125, pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Sipas nenit 59 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në kategorinë “lektorë” përfshihen si “anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, ashtu edhe ata që “kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie para fitimit të kësaj grade dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në statutin e institucionit të arsimit të lartë.” Referuar këtij formulimi ligjor, të gjithë pedagogët e Programit të Formimit Fillestar dhe të Formimit Vazhdues, që sipas ligjit 115/2016 dhe Rregullores së Brendshme, të miratuar nga Këshilli Drejtues, (Aneksi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

11)⁷, janë pjesë e stafit pedagogjik, dhe për të cilët nuk kërkohet si kusht pasja e gradës shkencore “doktor”, përfshihen në kategorinë “lektor”. Në këtë kuadër evidentohet se kundrejt kushtit prej tri vjet mësimdhënie për të qenë lektor në arsimin e lartë, pedagogu i Shkollës së Magjistraturës, qoftë i jashtëm, qoftë i brendshëm duhet të ketë një eksperiencë 15- vjecare si jurist, si dhe eksperiencë mësimdhënëse universitare apo në Shkollën e Magjistraturës mbi 10 vjet⁸. Kjo do të thotë se përzgjedhja si pedagog i Shkollës së Magjistraturës bazohet në kritere që jo vetëm nuk barazohen me ato të një lektori të së drejtës në arsimin e lartë, por dukshëm i tejkalon ato nga pikëpamja cilësore.

77. Duke i marrë së bashku, funksionet e sipërpërmendura publike, (prg.76), si dhe vetëm qenien pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli vlerëson se, kandidati plotëson kushtin e prej të paktën 15 vjet veprimtari profesionale, nga ato të parashikuara për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

78. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, sikurse parashtrohet në më sipër në këtë vendim, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidati Genti Ibrahimimi nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë kandidati Genti Ibrahimimi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

79. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike, Këshilli konstaton se kandidati Genti Ibrahimimi nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë Genti Ibrahimimi nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

80. Në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidati nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

⁷ Aneksi II i Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës në pikën **3.1 Emërtesa e stafit pedagogjik që aktivizohet në Shkollën e Magjistraturës**, parashikon:

“Stafi pedagogjik i Shkollës përbëhet nga pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm në Formimin Fillestar dhe trajnerët/ekspertët në Formimin Vazhdues, të specifikuar si më poshtë:

- a) **Pedagogët e brendshëm**, të cilët janë të përfshirë në veprimtarinë e Formimit Fillestar, të Formimit Vazhdues dhe në veprimtaritë shkencore, studimore dhe botuese të Shkollës;
- b) **Pedagogët e jashtëm të Formimit Fillestar**, të cilët përfshihen si pjesë e grupeve të lëndëve dhe kurseve, duke mbuluar një numër të konsiderueshëm orësh, duke filluar të paktën nga 8 orë në një ose disa kurse...”;

⁸ Aneksi II, pika 3.2 e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

81. Lidhur me kushtin e kandidimit mbi kalimin me sukses të kontrollit të pasurisë, sikurse evidentohet më lart, Këshilli vlerëson se duhet paraprakisht, të shpjegojë konceptin e “burimeve të ligjshme të të ardhurave” sipas legjislacionit tatimor, i zbatueshëm në kontekstin konkret.

82. Kështu, Këshilli çmon se për të përcaktuar se cilat do të konsiderohen burime të ligjshme të të ardhurave duhet t’i referohemi ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, në nenin 4 të tij, “**Burimi i të ardhurave**”, ku parashikohet se: “*Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë pa u kufizuar vetëm në to do të përfshijnë: a) të ardhurat nga marrëdhënia e punës të ushtruar në Republikën e Shqipërisë; b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë; c) të ardhurat nga veprimtaria e zhvilluar nga një person jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; d) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; dh) të ardhurat nga: i) pasuria e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë; ii) të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionit që u përket këtyre të drejtave; Të drejtat dhe informacioni i përmendur në nënndarjet “i” dhe “ii”, më sipër, për qëllime të këtij ligji, trajtohen si pasuri e paluajtshme. e) të ardhurat nga tjetërsimi i: i) pasurisë, të drejtave dhe informacionit të përmendur në shkronjën “dh” të këtij neni; ii) aksioneve ose interesave të ngjashëm, të tillë si interesat në ortakëri ose truste, sipas përkufizimeve në legjislacionet përkatëse, kudo që ndodhen, në qoftë se, në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këtyre aksioneve ose interesave të ngjashëm u buron më shumë se 50 për qind e vlerës direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme, të drejtat ose informacioni, të 5 përmendura në shkronjën “dh” të këtij neni. ë) të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident; f) të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente; g) të ardhurat nga interesat e paguar nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore ose nga një rezident i Republikës së Shqipërisë, ose që paguhet nga një jorezident, nëpërmjet një personi që ka seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; gj) të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfiteoza si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit; h) të ardhurat e një personi joresident, të përfuara si rezultat i shërbimeve të kryera për një person resident, i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.*

82. Nisur nga parashikimet e kësaj dispozite, sipas Këshillit, listimi me ligj i burimeve të krijimit të të ardhurës, dhe përcaktimi i tyre, krijon të ardhurat e ligjshme. Për rrjedhojë të ardhurën e ligjëron burimi i saj dhe jo pagimi i tatimeve, ashtu sikundër dhe pagimi i tatimeve nuk e bën të ardhurën të ligjshme, ajo vazhdon të mbetet e paligjshme nëse nuk provohet burimi i ligjshëm i saj. Për rrjedhojë, një e ardhur nuk klasifikohet nga legjislacioni financiar dhe tatimor si e paligjshme nëse mbi të nuk janë paguar detyrime tatimore.

83. Nga ana tjetër ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 89, parashikon detyrimin e subjekteve tatimore për pagesë tatimesh kur administrata e njofton se nuk ka paguar në mënyrë të plotë dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore. Edhe vetë subjekti tatimpagues, mund të kërkojë kontrollin tatimor dhe pagimin e detyrimeve tatimore edhe në kohë të mëvoshme, duke u aplikuar në këto raste dhe sanksionet përkatëse administrative. (neni 6, pika 3, neni 69, dhe 76 të ligjit).

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare: GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

84. Në kuptim të sa më lart, kandidati Ibrahimimi ka provuar se të ardhurat e tij dhe të personave të lidhur burojnë si nga trashëgimia, ashtu dhe nga marrëdhëniet e punësimit, dhe si të tilla ato konsiderohen të ligjshme. Megjithatë, konkretisht, në Aktin e kontrollit, ILDKP, ndërmjet të tjerash, ka konkluduar: *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat, që kanë shërbyer si burim i pjesshëm për krijimin e pasurive. (prg.43)*. Nisur veçanërisht nga kjo gjetje, Këshilli ka hetuar në mënyrë të thelluar, duke iu ridrejtuar organeve tatimore, ILDKPI, si dhe vetë kandidatit. Pasi nuk u arrit në konkluzion as pas këtyre veprimeve dhe marrjes së informacioneve perkatëse sa më lart shtjelluar, KED vendosi marrjen e mendimit të ekspertit kontabël mbi disa çështje të kontrollit të pasurisë.

84. Në Aktin e Ekspertimit, bazuar edhe në informacionin e dhënë nga organet tatimore ekspertes kontabël, në mënyrë të përmbledhur sqarohet se: *"... Referuar pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, kandidati i mbulon shpenzimet për cdo vit. (fq.84). pagesat i ka të gjitha me rrugë bankare, të krijuara nga marrëdhëniet kontraktore (fq.88). Sa i përket mungesës së dokumentacionit justifikues për pagesën e tatimeve, është e pamundur të përcaktohet nëse kandidati ka tatime në burim të papaguara, pasi deklarimi për tatimin e mbajtur në burim në sistemin informatik pranë organeve përgjegjëse tatimore ka filluar në dhjetor 2014, ndërsa për periudhat e mëparshme pagesat e tatimit në burim janë jashtë sistemit informatik. Megjithatë, në regjistrin e pagesave jashtë sistemit informatik nga viti 2008 deri në Nentor 2014, u kontrollua dhe kishte hedhje pagesash tatimi në burim, por që nuk identifikoheshin kujt i përkisnin..."*. (ibid. fq.88, fq.94).

85. Për sa më lart, Këshilli konstaton se nga njëra anë, ILDKPI ka evidentuar mungesën e dokumentacionit justifikues për pagimin e tatimeve për një pjesë të të ardhurave, ndërsa nga ana tjetër ekspertja kontabël ka konkluduar pamundësinë objektive të gjetjes së këtij dokumentacioni para muajit Dhjetor të vitit 2014. Në këto kushte, Këshilli vlerëson se bazuar mbi parimin e proporcionalitetit, barra për pamundësinë objektive të gjetjes së dokumentacionit justifikues nuk duhet të rëndojë vetëm mbi kandidatin. Si konkluzion, për shkak se kandidati ka arritur të paraqesë dokumente mbështetëse dhe provues për natyrën e ligjshme të të ardhurave të tij, dhe se mosgjetja e dokumentacionit provues mbi pagimin e tatimeve për një pjesë të të ardhurave nuk duhet të jetë detyrim vetëm i kandidatit, nisur sidomos nga koha e largët, kur disa nga të ardhurat janë krijuar dhe për të cilat nuk ka dokumentacion tatimor, por edhe detyrim i institucioneve tatimore përgjegjëse për administrimin e informacionit, vlerëson kalimin me sukses të kontrollit të pasurisë. Sa i përket gjetjeve të tjera të konkluduara në Akt kontrollin e ILDKPI, Këshilli pasi i analizoi, së bashku me prapësimet e kandidatit, vlerëson se ato nuk kanë qenë të asaj natyre përcaktuese për rezultatin e këtij procesi.

86. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundim se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit Genti Ibrahimimi, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 13.01.2022.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 3 të nenit 229 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidatit Genti Ibrahim, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 13.01.2022.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Genti Ibrahim.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR
Sokol BINAJ



The image shows a circular official stamp of the Council of Judges in the Republic of Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE", "KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI", and "TIRANË". In the center of the stamp is the coat of arms of Albania. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302